



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 528 Akti

Nr. 590 Vendimi
Tiranë, më 23.11.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Brunilda Bektoshi	Relatore
Pamela Qirko	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 21.11.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Vjola Canaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bektoshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, referuar pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).

2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.6.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Roland Ilia, Brunilda Bekteshi dhe Pamela Qirko. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.

4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 19.6.2020, të trupit gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj, si dhe caktoi kryesues të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

5. Në datën 22.7.2020 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, sipas kërkesës së Komisionit, ka deklaruar mungesën e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

6. Në datën 8.11.2022 Komisioni, me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Vjola Canaj për të tria kriteret e rivlerësimit vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatorja e çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të paraqesë pretendimet e tij brenda datës 17.11.2022 nga marrja e njoftimit me postë elektronike, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Po në datën 8.11.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua lidhur me: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iii) të sjellë prova për të provuar të kundërtën brenda 9 ditëve. Në datën 9.11.2022 subjekti paraqiti kërkesën për njohjen me dosjen, duke depozituar edhe prokurën e posaçme të përfaqësimit me nr. ***, datë 9.11.2022. Në datën 17.11.2022 subjekti dërgoi në mënyrë elektronike dhe zyrtare shpjegimet dhe provat, të protokolluara me nr. *** prot., datë 17.11.2022, duke parashtruar kërkesën për marrje provash mbi rezultatet e hetimit, të cilat u pranuan/administruan¹ nga Komisioni.

¹ Komisioni, me anë të postës elektronike, po në datën 17.11.2022, e njoftoi subjektin për administrimin e dokumentacionit të depozituar prej saj.

8. Trupi gjykues, në datën 17.11.2022, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Vjola Canaj në seancën dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, duke e njoftuar² se seanca do të zhvillohej në datën 21.11.2022, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit Vjola Canaj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma. Gjatë seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit, përfaqësuar me prokurë të posaçme nr. **, datë 9.11.2022, nga avokati pranë Dhomës së Avokatisë Vlorë, z. K.Z (njëkohësisht bashkëshorti i saj), me nr. licence ***, shprehu qëndrimin lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të parashtrimeve përfaqësuesi ligjor i subjektit të rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

10. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Vjola Canaj. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 21.11.2022, për të rifilluar në datën 23.11.2022 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

11. Znj. Vjola Canaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar ndaj saj.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

12. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit. KLGJ-ja është organi ndihmës i ngarkuar me ligj për të paraqitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar në lidhje me vlerësimin profesional. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese³ dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues,

² Datë 17.11.2022.

³Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkapëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

13. ILDKPKI-ja, me raportin nr. *** prot., datë 8.11.2019, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, dhe në datën 27.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur me të, për vlerësimin e pasurisë ky institucion ka konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

14. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat e administruara gjatë hetimit nga institucionet përgjegjëse; (ç) deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas mbylljes së hetimit administrativ; si dhe (dh) shpjegimet e dhëna në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

15. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; si dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16. Mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, sipas formularit (shtojca nr. 2) të datës 27.1.2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, nga hetimi rezulton se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë deklaruar në deklaratën *Vetting* pasuritë si vijon:

1. Shtëpi banimi me sipërfaqe 78 m², me adresë: lagjja “****”, Vlorë, ndërtuar në vitin 2008, me çmimin 32.000 euro, paguar 32.000 euro, me pjesë takuese 50% Vjola Canaj dhe 50% K.Z, kaluar në pronësi me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.1.2017. Shuma 20.000 euro është marrë hua nëpërmjet kredisë bankare të deklaruar në vijim. Shuma 10.000 euro është përballuar nga kursimet e të fejuarit (në atë kohë) K.Z, ndërsa shuma 2.500 euro është përballuar nga subjekti i rivlerësimit për pasurinë e llojit “apartament”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴.

1.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ASHK-së Vlorë.*

Faktet e rezultuara nga hetimi i Komisionit

1.2 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë të vitit 2007, me përshkrimin “Apartament banimi me sipërfaqe 84 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, me aktmarrëveshjen e lidhur në datën 16.8.2007, lidhur me shoqërinë ndërtuese ‘K’ sh.p.k. Si palë në kontratë ka qenë shtetasi K.Z (bashkëshorti), martesë është lidhur në datën 21.1.2008. Kredia e deklaruar në faqen 5 të deklaratimit të vitit 2007 është marrë për blerjen e këtij apartamenti. Kredimarrës jam unë dhe K.Z. Kredia është marrë gjatë bashkëjetesës”. Vlera e apartamentit është 36.400 euro.

1.2.1 Po në këtë deklaratë, subjekti ka deklaruar si detyrim të mbetur ndaj shoqërisë “K” sh.p.k. shumën 6.400 euro, i rrjedhur nga kontrata e porosisë datë 16.8.2007.

1.2.2 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti deklaroi se ka shlyer 2.500 euro dhe detyrim të mbetur nga kontrata e sipërmarrjes 3.900 euro. Në deklaratat periodike të viteve 2009-2013 subjekti ka deklaruar detyrimin e mbetur prej 3.900 euro ndaj shoqërisë “K” sh.p.k. Në deklaratat në vijim nuk rezultoi të ketë më deklarime për këtë detyrim financiar.

1.3 Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 8.11.2019⁵, Drejtoria Vendore e ASHK-së Vlorë ka konfirmuar pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 78 m², me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, vol. ***, f. ***, në emër të shtetasve K.Z dhe Vjola Canaj (në bashkëpronësi në ½ pjesë takuese).

⁴ (a) Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.1.2017, me palë shitëse shoqëria “K” sh.p.k. dhe palë blerëse K.Z e Vjola Canaj, për blerje apartamenti me sip. 78 m², lagjja “****”, Vlorë. Vlera: 32.000 euro. Shuma është likuiduar nëpërmjet bankës, shoqëruar nga konfirmat bankare bashkëlidhur kësaj kontrate sipas kontratës së porosisë datë 16.8.2007 lidhur mes palëve; (b) certifikatë për vërtetim pronësie datë 15.10.2010, për apartament me sip. 78 m², nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. *** në pronësi të shoqërisë “K” sh.p.k. + kartelë pasurie me të dhëna të njëjta; (c) kontratë porosisë datë 16.8.2007, me palë shoqërinë “K” sh.p.k. dhe z. K.Z për porositje apartamenti me sip. 84 m². Vlera: 36.400 euro. Paga do të kryhet me këste: kësti i parë 10.000 euro paguhet me lidhjen e kontratës, kësti i dytë 10.000 euro në datën 30.9.2007, kësti i tretë 10.000 euro në datën 30.10.2007; dhe kësti i katërt 6.400 euro me marrjen e çelësve në dorë; (ç) mandatarkëtim datë 16.8.2007, e “Emporiki Bank”, ku z. K.Z paguan shumën 10.000 euro si këst për blerje apartamenti; (d) transfertë datë 4.10.2007, e “Emporiki Bank”, ku z. K.Z transferon shumën 19.500 euro në favor të shoqërisë “K” sh.p.k.; (dh) mandatarkëtim datë 7.5.2008, e “Emporiki Bank”, ku z. K.Z paguan shumën 2.500 euro si këst për blerje apartamenti; (e) kontratë kredie nr. ***, datë 26.9.2007, me palë kredihënëse Banka Kombëtare e Greqisë, palë kredimarrëse Vjola Canaj e K.Z, palë dorëzënëse L, H dhe H.Z, për marrje kredie në shumën 20.000 euro, me qëllim blerje apartamenti në lagjen “****”, Vlorë. Si kolateral vendoset pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve H, L dhe H.Z + kartelë pasurie për apartament me sip. 77 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. *** Vlorë, në bashkëpronësi të shtetasve H, L dhe H.Z; (ë) kontratë hipoteke nr. ***, datë 26.9.2007, me palë përfituese Banka Kombëtare Greke dhe palë hipotekuese shtetasit L, H dhe H.Z, ku për kredinë e marrë nga Vjola Canaj dhe K.Z në shumën 20.000 euro pala hipotekuese lë si garanci apartamentin në bashkëpronësi të H, L dhe H.Z + certifikata e pronësisë së apartamentit me sip. 77 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Vlorë, në bashkëpronësi të shtetasve H, L dhe H.Z; (f) deklaratë noteriale nr.*** rep, nr.*** kol, dt.25.1.2017 me deklarues shoqëria “K” sh.p.k., K.Z dhe Vjola Canaj. Sipas kësaj deklarate, palët kanë lidhur kontratën e shitjes nr. ***, datë 25.1.2017, e cila është përfundimi i marrëdhënies paraprake të krijuar mes tyre me kontratën e porosisë datë 16.8.2007, për porositjen e apartamentit me sip. 84 m² me vlerë 36.400 euro. Pas përfundimit të ndërtimit të banesës dhe procedurave të regjistrimit ka rezultuar se sipërfaqja e apartamentit është 78 m², pra më e vogël se sipërfaqja e apartamentit të porositur që ka qenë 84 m². Duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët pranuan mes tyre të ndryshojnë çmimin e shitblerjes nga 36.400 euro në 32.000 euro, shumë e cila është likuiduar më parë nëpërmjet “Emporiki Bank” (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

ZVRPP-ja i ka bashkëlidhur *email*-it edhe praktikën e regjistrimit të kësaj pasurie, si: (a) kartelë pasurie për apartamentin me sip. 78 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve Vjola Canaj dhe K.Z; (b) kontratë porosie datë 16.8.2007, me palë shoqërinë “K” sh.p.k. dhe shtetasit K.Z dhe Vjola Canaj për porositjen e apartamentit me sip. 84 m², në vlerën 36.400 euro; (c) kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.1.2017, me palë shitëse shoqërinë “K” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit K.Z e Vjola Canaj për blerje apartamenti me sip. 78 m², lagjja “****”, Vlorë – vlera e apartamentit në kontratën e shitjes është 32.000 euro; (ç) dokumentacion bankar të likuidimit të pasurisë së paluajtshme, konkretisht: mandatarëkëtim datë 16.8.2007, për depozitimin e shumës 10.000 euro në llogarinë e shoqërisë “K” sh.p.k. në “Emporiki Bank”; transfertë fondesh në datën 4.10.2007, në shumën 19.500 euro në llogarinë e shoqërisë “K” sh.p.k. në “Emporiki Bank”; mandatarëkëtim datë 7.5.2008, për depozitimin e shumës 2.500 euro në llogarinë e shoqërisë “K” sh.p.k. në “Emporiki Bank”.

1.4 FSHU-ja⁶ informon se me gjeneralitetet K H Z identifikohet një abonent me kontratën e furnizimit me nr. *** në instancën Vlorë, me datë hapjeje 20.6.2008.

1.5 UKT-ja⁷ informon se nuk rezulton asnjë e dhënë për kontrata për shërbime Ujësjetllës - Kanalizime Tiranë sh.a., të regjistruar në sistem në emër të subjektit të rivlerësimit apo familjarëve të saj.

1.5.1 Komisioni e ka pyetur⁸ subjektin për këtë fakt, e cila, në përgjigje të saj, ka depozituar: vërtetimin nr. *** prot., datë 28.9.2022, të lëshuar nga Ujësjetllës - Kanalizime Vlorë sh.a., i cili vërteton se shtetasi K.H.Z është klient familjar me nr. kontrate *** dhe nr. klienti ***.

1.6 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie dhe likuidimin e saj, nga hetimi administrativ rezulton se në deklaratën *Vetting* subjekti rivlerësimit deklaroi se burim krijimi për këtë pasuri janë: (i) 10.000 euro kursimet e të fejuarit (në atë kohë) K.Z; (ii) 20.000 euro kredi bankare; (iii) 2.500 euro nga subjekti.

1.6.1 Nga hetimi rezultoi se kjo pasuri fillimisht është porositur me kontratën e porosisë⁹ datë 16.8.2007 (jo kontratë noteriale) me palë shoqërinë “K” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe shtetasve Vjola Canaj dhe K.Z, në cilësinë e porositësve për apartamentin me sipërfaqe totale 84 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, në vlerën 36.400 euro.

1.6.2 Sipas kësaj kontrate porosie parashikohej se pagesat për këtë pasuri do të kryheshin me këste, dhe konkretisht: (i) kësti i parë prej 10.000 euro në momentin e lidhjes së kontratës së porosisë në datën 16.8.2007; (ii) kësti i dytë prej 10.000 euro në datën 30.9.2007; (iii) kësti i tretë prej 10.000 euro në datën 30.10.2007; dhe (iv) kësti i katërt prej 6.400 euro në momentin e marrjes së çelësave të apartamentit në dorë.

1.6.3 Më tej rezulton se kjo pasuri është finalizuar përmes lidhjes së kontratës së shitblerjes për apartamentin nr. ***, në datën 25.1.2017, e regjistruar në ZVRPP-në Vlorë, z.k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, indeks harte VL-L-11, kundrejt çmimit të përcaktuar në kontratën e shitblerjes, në total 32.000 euro, me sipërfaqe të shfrytëzueshme të apartamentit 78 m² dhe 6 m² sipërfaqe të përbashkët, referuar planimetrisë bashkëlidhur kësaj kontrate.

⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 14.8.2020.

⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 20.8.2020.

⁸ Pyetësor nr. 2, datë 15.9.2022.

⁹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

1.6.4 Nga hetimi¹⁰ rezulton se likuidimi i vlerës së kontratës është kryer konkretisht: (i) shuma 10.000 euro në datën 16.8.2007; (ii) shuma 19.500 euro në datën 1.10.2007; dhe (iii) shuma 2.500 euro në datën 7.5.2008.

1.6.5 Paraprakisht, për këtë pasuri, referuar të dhënave në kontratën e porosisë krahasuar me të dhënat e përcaktuara në kontratën e shitjes, Komisioni konstatoi ndryshime të çmimit dhe sipërfaqes. Më konkretisht, në kontratën e porosisë sipërfaqja e apartamentit pasqyrohej 84 m² me çmim 36.400 euro, ndërsa në kontratën e shitjes pasqyrohej me sip. 78 m² me çmim 32.000 euro.

1.6.6 Lidhur me këtë konstatim, Komisioni nga hetimi¹¹ administrativ evidentoi faktin se në datën e nënshkrimit të kontratës së shitjes, 25.1.2017, rezultonte se palët (shoqëria “K” sh.p.k., K.Z dhe Vjola Canaj) kanë nënshkruar gjithashtu edhe një deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.1.2017, në të cilën kanë deklaruar se: *“Kontrata e shitblerjes me të dhënat e sipërshënuara është përfundimi i marrëdhënies paraprake të krijuar mes tyre, bazuar në aktin noterial ‘kontratë porosie’ datë 16.8.2007, për blerje të pasurisë ‘apartament’ me sip. 84 m², kati i pestë banimi, me orientim gjeografik lindje, kundrejt çmimit të pranuar 36.400 euro. Pas përfundimit të ndërtimit të banesës shumëkatëshe dhe përfundimit të procedurës së regjistrimit të kësaj banese pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, ka rezultuar se në fakt sipërfaqja e apartamentit objekt shitblerjeje ka qenë 78 m², pra më e vogël se sipërfaqja e apartamentit të porositur për blerje, e cila ka qenë 84 m². Duke marrë në konsideratë sa më sipër, palët pranuan mes tyre të ndryshojnë çmimin e shitblerjes së pasurisë ‘apartament’ nga shuma 36.400 euro në shumën 32.000 euro, shumë e cila deklarohet nga palët se është likuiduar mes tyre tërësisht gjatë fazës së ndërtimit të banesës shumëkatëshe, pjesë e së cilës është edhe pasuria ‘apartament’ objekt shitblerjeje, likuidim i realizuar nëpërmjet llogarive bankare të palëve dhe i konfirmuar me konfermat bankare përkatëse...”*.

1.6.7 Sipas kontratës së shitjes rezultonte se pasuria objekt kontratë shitblerjeje (neni 3 i saj) përfshinte sipërfaqen 84 m², nga e cila 78 m² sipërfaqe e shfrytëzueshme dhe 6 m² sipërfaqe e përbashkët, sipas planimetrisë së apartamentit bashkëlidhur kësaj kontrate. Referuar praktikës së regjistrimit të ish-ZVRPP-së Vlorë, specifikisht kartelës së pasurisë, vërehet se sipërfaqja e përbashkët nuk ishte përcaktuar/përfshirë në regjistrimin e këtij apartamenti.

1.6.8 Gjithashtu, Komisioni hetoi më tej në lidhje me ndonjë trajtim preferencial të mundshëm në përfitimin e kësaj pasurie. Komisioni i është referuar udhëzimit nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive për vitin 2007”. Sipas udhëzimit rezulton se vlera mesatare e shitblerjeve të banesave në tregun e lirë për vitin 2007 për qytetin e Vlorës është 49.335 lekë/m².

1.6.9 Komisioni, duke u bazuar në çmimet referuese, konstatoi se apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit me sipërfaqe të shfrytëzueshme 78 m² ka vlerën 3.848.130 lekë. Në këtë drejtim, Komisioni ka konstatuar se kjo vlerë është me e ulët nga çmimi që ka paguar subjekti, pasi apartamenti është blerë në vlerën 3.935.256 lekë. Por edhe duke i qëndruar sipërfaqes prej 84 m² në kontratën e porosisë, vlera e apartamentit do të ishte 4.144.140 lekë (49.335 lekë/m² x 84 m²), duke u bazuar në çmimet referuese. Kjo vlerë, duke u krahasuar me shumën e paguar nga subjekti prej 3.935.256 lekësh, rezulton të jetë 208.884 lekë më e lartë.

1.6.10 Po për këtë pasuri Komisioni ka hetuar edhe në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit dhe bazuar në dokumentacionin e administruar nga institucioni punëdhënës¹² u konstatua se në

¹⁰ Aneks nr. *** dhe nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2020, nga ABI Bank.

¹¹ Aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

¹² Shkresë datë 29.9.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, e depozituar nga subjekti me pyetësorin nr. 2, datë 15.9.2022.

asnjë rast nuk konfirmoi shqyrtimin e çështjeve gjyqësore me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K” sh.p.k., me përfaqësues ligjor shtetasin A.P.

1.6.11 Lidhur me konstatimin e ndryshimit të vlerës së shitjes së pasurisë apartament, referuar kontratave të porosisë dhe asaj të shitblerjes, si dhe çmimeve referuese, Komisioni¹³ i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime bindëse, duke depozituar kontrata të ngjashme me planimetri të njëjtë me pasurinë objekt deklarimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.7 Në qëndrimin e saj, subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë konstatim të Komisionit, ka parashtruar se me kontratën e porosisë datë 16.8.2007, për blerje të pasurisë apartament, palët kanë rënë dakord që objekt porosisë është pasuria që do të shitet në të ardhmen, me sip. 84 m², kundrejt vlerës 36.400 euro, ndërkohë për sipërfaqet funksionale palët shprehen: *“Nëpërmjet kësaj aktmarrëveshjeje porositësi konfirmon se për pjesët në bashkëpronësi (toka që zë banesa, trotualet, sipërfaqet funksionale etj.) do t’i nënshtrohen të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me të”*. Ky parashikim nënkupton që sipërfaqet e përbashkëta nuk përfshihen në sip. 84 m².

1.7.1 Pas përfundimit të sendit dhe regjistrimit të tij, ka rezultuar që sipërfaqja e apartamentit të porositur ka qenë 78 m² dhe referuar planimetrisë së tij dhe akteve të regjistrimit në regjistrimin e pasurive të paluajtshme, sipërfaqja e përbashkët është përcaktuar të jetë 6 m².

1.7.2 Sipas subjektit, për shkak se sipërfaqja e apartamentit është zvogëluar me më shumë se 1/20-at e tij (konkretisht me 1/14-at), bazuar në nenin 753 të Kodit Civil, sipas të cilit: *“Në rastin kur çmimi përcaktohet në lidhje me vetë sendin e paluajtshëm dhe jo me madhësinë e tij, edhe pse kjo është dhënë, nuk bëhet ulje ose ngritje çmimi, përveçse kur madhësia reale është më e vogël ose më e madhe se një e njëzeta pjesë e asaj të treguar në kontratë”*, blerësve Vjola Canaj dhe K.Z u ka lindur e drejta për zbritjen e çmimit në raport me zvogëlimin e sipërfaqes. Për këtë arsye, palët kanë rënë dakord me akt noterial për zbritjen e çmimit, në të njëjtën formë siç edhe kanë shprehur vullnetin për lidhjen e kontratës.

1.7.3 Në seancë dëgjimore¹⁴ subjekti parashtroi se pallati ka qenë duke u ndërtuar dhe këstet e apartamentit janë paguar gati 1 vit para dhe në momentin që kanë lidhur kontratën paraprake të porosisë nuk është konstatuar nga ana e tyre se sa metra katrorë do të ishte sipërfaqja totale e kësaj pasurie.

1.7.4 Subjekti ka parashtruar se në momentin që hynë në banesë kishin paguar gati 32.400 euro, të cilat ishin këstet sipas radhës për të hyrë në apartament, duke konstatuar kështu edhe faktin që sipërfaqja nuk ka qenë 84 m², por 78m², fakt i cili ka zgjatur gati 8 vjet në një konflikt verbal me ndërtuesin derisa kanë arritur në konkluzionin e një marrëveshjeje, në të cilën shoqëria ndërtuese ka pranuar këtë fakt dhe ka ardhur të bëjë matjet e apartamentit.

1.7.5 Subjekti¹⁵ ka shpjeguar se në fillësë vlera e kësaj pasurie prej 36.400 euro ka të bëjë me një sipërfaqe prej 90 m², që aty nuk është pasqyruar, pra sipërfaqja e shtëpisë duhej të ishte 90 m² bashkë me ambientet e përbashkëta, e cila, e përkthyer në 36.000 euro/90 m², duhej të ishte 400 euro m² sipas përlllogaritjeve që janë bërë në atë kohë.

¹³ Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁴ Referohuni deklarimeve e përfaqësuesit ligjor në pg. 1.7.3 - 1.7.6 të këtij vendimi.

¹⁵ Shpjegimi i subjektit në seancën dëgjimore të datës 21.11.2022.

1.7.6 Në lidhje me kontrata të tjera të ngjashme të këtij seksioni të pallatit, subjekti shpjegoi se nuk ka pasur mundësi të gjejë ndonjë kontratë të tillë, për arsye se ato shtëpi janë shitur, duke ndryshuar shumë herë pronarët.

1.8 Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.8.1 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi, duke pasur parasysh faktet e dala nga hetimi, në analizë të parashikimeve ligjore kontraktuale sipas dispozitave ligjore përkatëse, në raport me shpjegimet e subjektit, arsyeton:

1.8.2 Referuar kontratës së porosisë parashikohet se *nëpërmjet kësaj aktmarrëveshjeje porositësi konfirmon se për pjesët në bashkëpronësi (toka që zë banesa, trotualet, sipërfaqet funksionale etj.) do t'i nënshtrohen të gjitha akteve ligjore dhe nënligjore që lidhen me të dhe se në këtë kontratë nuk është parashikuar sipërfaqja bruto apo neto, si dhe më tej ajo e përbashkët. Mbi këtë parashikim kontraktual, në raport me dispozitat ligjore të Kodit Civil që rregullojnë bashkëpronësinë e detyrueshme “objektet e përbashkëta të ndërtesave”, dhe specifikisht neni 209 i tij, rezulton se blerësi/pronar i një apartamenti apo një njësie e cila ndodhet në një pallat, bëhet automatikisht edhe bashkëpronar i pjesës takuese të sipërfaqes së përbashkët (trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose tarraca, oxhaqet, si dhe të gjitha ato objekte të ndërtesës që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët).*

1.8.3 Referuar kontratës së porosisë të vitit 2007, trupi gjykues ka konstatuar se nuk rezulton të jetë përcaktuar sipërfaqja e përbashkët. Trupi gjykues, në këtë çështje objekt vlerësimi, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi, evidenton faktin se kontratat e porosisë u bënë të detyrueshme për regjistrim nga subjekti ndërtues pranë ZVRPP-ve me ndryshimet ligjore të ligjit nr. 9/2016, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 33/2012, ‘Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme’”, neni 46, pika 2 e tij, ku përcaktohet qartë se pas regjistrimit të lejes së ndërtimit nga ndërtuesi, regjistruesi, sipas kërkesave të paraqitura nga personat e interesuar, regjistrojnë në regjistrin e veçantë, në të cilin është regjistruar leja e ndërtimit, aktet noteriale, si dhe kontratat e sipërmarrjes/porosisë të lidhura ndërmjet zhvilluesit të pronës, në cilësinë e investitorit, dhe pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njëjësive individuale, që përbëjnë strukturën që do të ndërtohet, bazuar në lejen e ndërtimit. Zhvilluesit e pronës apo pronarët e truallit nuk mund të lidhin kontrata sipërmarrjeje apo porosie pa regjistruar lejen e ndërtimit. Subjekti ndërtues në momentin e përfundimit të ndërtimit të objektit dhe pas kolaudimit të tij (regjistrimi i lejes së ndërtimit referuar neneve 46 dhe 48 të ligjit nr. 33/2012) është i detyruar që të bëjë regjistrimin e gjithë sipërfaqes ndërtimore, në të cilën përfshihen si sipërfaqet e banimit, ashtu edhe ato të përbashkëta. Si rrjedhojë, në momentin e shitjes së një njësie ndërtuesi duhet t'i kalojë pronësinë blerësit automatikisht, si për sipërfaqen e brendshme, ashtu edhe për pjesën takuese të sipërfaqes së përbashkët.

1.8.4 Trupi gjykues, referuar situatës faktike të kësaj çështjeje, në raport me rregullimet ligjore të përshkruara më sipër, e ka çmuar bazuar në fakte provuese të tilla:

i) Në kontratën e shitblerjes¹⁶ parashikohet vullneti i palëve për detyrimin ligjor mbi përcaktimin e sipërfaqes së përbashkët prej 6 m², shoqëruar me planimetrinë përkatëse në të cilën është e përcaktuar sipërfaqja e shfrytëzueshme 78 m² dhe sipërfaqja e përbashkët 6 m².

¹⁶ Referohuni praktikës së regjistrimit të dërguar nga ASHK Drejtoria Vendore Vlorë me e-mail-in e datës 8.11.2019 (aneks nr. 28).

ii) Rezultoi se ndryshimi i sipërfaqes në raport me çmimin është parashikuar në deklaratën noteriale në të njëjtën datë me lidhjen e kontratës së shitblerjes, pra në kohë reale.

iii) Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar së është një pasuri e ndërtuar në vitin 2008, deklarim i cili mbështet shpjegimet e saj se pallati ka qenë në ndërtim dhe se pagesat e çmimit të pasurisë ishin kryer para ndërtimit, me përjashtim të këstit të fundit që do të likuidohet në momentin e marrjes së çelësave në dorë të apartamentit, duke i vlerësuar bindëse shpjegimet e subjektit dhe, për rrjedhojë, konkludon se nuk lindin dyshime në lidhje me çmimin e paguar dhe të deklaruar për këtë pasuri.

1.9 Lidhur me ligjshmërinë e secilit burim krijimi për këtë pasuri, nga hetimi administrativ i Komisionit ka rezultuar si vijon:

1.9.1 Në lidhje me shumën 10.000 euro, kursimet e të fejuarit (në atë kohë) K.Z

Komisioni, nga aktet e administruara, ka konstatuar se kjo shumë është paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së porosisë, 16.8.2007. Këtë burim subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007. Komisioni e ka pyetur¹⁷ subjektin për burimin e krijimit të shumës 10.000 euro, e cila, në përgjigje të saj, ka shpjeguar se: “*Shuma e paguar nga bashkëshorti prej 10.000 euro kanë qenë kursime të tij dhe të familjes, të përbërë nga ai, prindërit dhe halla e tij, e cila ka jetuar me ta dhe nuk ka lidhur martesë e nuk ka fëmijë. Këto kursime të të gjithë familjes përgjatë gjithë jetës së tyre, duke qenë djalë i vetëm, familjarët ia kanë dhënë me qëllim blerjen e banesës me rastin e martesës së ardhshme*”. Subjekti, në mbështetje të deklaramit, ka depozituar disa dokumente për të provuar të ardhurat e bashkëshortit dhe familjarëve të tij.

1.9.2 Komisioni, nga analizimi i dokumentacionit¹⁸ të depozituar nga subjekti për periudhën deri në gusht të vitit 2007, kur është likuiduar kësti i parë, ka konstatuar se familja e bashkëshortit ka realizuar të ardhura për sa rezulton:

- i. babai i bashkëshortit, për periudhën 1994 – gusht 2007, ka përfituar shumën 2.067.309 lekë, sipas vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto*;
- ii. halla e bashkëshortit, për periudhën 1992 – gusht 2007, ka përfituar shumën 1.072.190 lekë, sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 10.10.2022, nga ISSH Drejtoria Rajonale Vlorë;
- iii. për të ardhurat e bashkëshortit, subjekti ka depozituar vërtetim, datë 22.11.2019, të lëshuar nga Shoqata Kombëtare e Minifutbollit, për të provuar punësimin e tij për vitet 2003 - 2005, si dhe lëvizje llogarie, datë 20.10.2022, në “ProCredit Bank”, në monedhën lekë, dollarë dhe euro, paga dhe honorare nga puna në këtë shoqatë.

1.9.3 Komisioni, nga analizimi i *statement*-it të “ProCredit Bank”, ka konstatuar se nuk rezultonin kreditime në llogari nga Shoqata Kombëtare e Minifutbollit për pagën apo honoraret sipas pretendimit të subjektit. Rezultonte se bashkëshorti i subjektit ka depozituar *cash* në datën 15.12.2004 shumat 1.000 euro dhe 700 USD. Këto shuma janë investuar në depozita dhe janë tërhequr në datën 18.3.2005, përkatësisht 1.003 euro dhe 701 USD. Gjithashtu rezultonte se bashkëshorti i subjektit ka kryer depozitime *cash* në llogarinë në lekë, përkatësisht: (a) në datën 18.3.2005 ka depozituar shumën 30.000 lekë; (b) në datën 18.3.2005 ka depozituar shumën 191.560 lekë; (c) në datën 27.7.2005 ka depozituar shumën 70.000 lekë; (ç) në datën 27.7.2005 ka depozituar shumën 70.000 lekë; dhe (d) në datën 20.7.2005 ka depozituar shumën 20.000 lekë, e cila është tërhequr brenda shtatorit të vitit 2005.

¹⁷ Pyetësor nr. 2, datë 15.9.2022.

¹⁸ Depozituar pranë Komisionit me nr. *** prot., datë 24.10.2022 (përgjigjet e pyetësorit nr. 3 datë 6.10.2022).

1.9.4 Komisioni, duke konstatuar se shumata e sipërcituara nuk kishin përshkrim lidhur me burimin dhe nuk provoheshin se ishin të ardhura nga punësimi në Shoqatën Kombëtare të Minifutbollit, nuk i ka përfshirë në analizën financiare të kryer.

1.9.5 Subjekti, për të provuar të ardhura të tjera të përfituara nga bashkëshorti apo kursime që familja e tij i ka disponuar më parë, ka depozituar dokumentacionin si vijon:

- i. kontratë shitjeje nr. ***, datë 17.12.2002, për shitjen e automjetit në emër të bashkëshortit në vlerën 240.000 lekë. Subjekti, sipas kërimit¹⁹ të Komisionit në lidhje me blerjen e këtij automjeti dhe dokumentacionin përkatës, deklaroi se për shkak të kohës së largët nuk kanë mundur të gjejnë kontratën e kalimit të pronësisë, për të cilën bashkëshorti mendon se i përket periudhës 1999 – 2001. Komisioni deri në fazën e hetimit administrativ nuk i ka përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e automjetit, pasi nga njëra anë subjekti nuk ka paraqitur kontratën e blerjes së këtij mjeti dhe, nga ana tjetër, vlerësoi se e njëjta shumë që mund të jetë shpenzuar për blerjen e tij në vitet 1999 – 2001 mund të jetë marrë edhe nga shitja, thënë ndryshe shumata e shpenzuar për blerjen e automjetit dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e tij kompensojnë njëra-tjetrën në vlerë;
- ii. shkresë të “Raiffeisen Bank” lidhur me një llogari kursimi të ish-Bankës së Kursimeve në emër të babait të bashkëshortit, ku gjendja e llogarisë më 31.12.1999 është 208.689 lekë;
- iii. balanca e llogarisë së nënës së bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, me shumë në tërheqje me lekë të kursyera në datën 15.11.2006 në vlerën 150.000 lekë;
- iv. balanca e llogarisë së hallës së bashkëshortit në “Raiffeisen Bank”, me shumë në tërheqje me lekë të kursyera në datën 16.1.2007 në vlerën 160.000 lekë.

1.9.6 Komisioni, nga analizimi i *statement*-it bankar, konstatoi se nëna e bashkëshortit ka pasur depozitë në “Raiffeisen Bank” (me tepicë të mbartur nga ish-Banka e Kursimeve në datën 12.5.2005, në vlerën 250.000 lekë). Rezulton se në datën 15.11.2006 ajo ka tërhequr nga llogaria shumën 153.400 lekë, ndërsa diferenca ka vazhduar të jetë e investuar në depozitë deri në vitin 2008. Shuma e përfituar nga interesat për periudhën 2005 – 2007 është 15.521,17 lekë.

1.9.7 Gjithashtu, gjatë hetimit ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***, konfirmuar nga DPSHTRR-ja²⁰. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 19.7.2005, me palë shitëse shtetasin E.L dhe palë blerëse shtetasin K.Z, të automjetit tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në vlerën 230.000 lekë. Ky automjet rezulton i çregjistruar përfundimisht në datën 19.1.2017. Bashkëshorti i subjektit rezulton se këtë automjet e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 (kur është bërë person i lidhur me subjektin për shkak të martesës në datën 21.1.2008), me përshkrimin “Autoveturë e markës ‘Mercedes-Benz’, tip 190, viti i prodhimit 1987, targa ***. Çmimi 230.000 lekë, blerë me kontratën nr. ***, datë 19.7.2005. Burimi i krijimit janë kursime personale nga punësimi *part-time* si barist pranë diskos “***”, Vlorë”.

1.9.8 Komisioni, bazuar në dokumentacionin e administruar për të ardhurat dhe shpenzimet e identifikuar deri në këtë fazë të hetimit, pas analizimit të tyre në përmbushje të kushteve ligjore të nenit D të Kushtetutës dhe kryerjes së analizës financiare²¹, konstatoi se familjarët e bashkëshortit nuk kanë pasur mundësi të kursejnë shumën 10.000 euro dhe, për pasojë, nuk provohej burimi i ligjshëm për pagesën e këstit të parë.

¹⁹ E-mail datë 18.10.2022.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 19.8.2020.

²¹ Referohuni analizës financiare të Komisionit materializuar në rezultatet e hetimit.

1.9.9 Komisioni në vijim kreu analizën financiare (referohuni tabelës nr. 2) të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit për vitin 2007, kur është investuar në blerjen e apartamentit. Në analizë nuk janë përfshirë kursimet e bashkëshortit në vlerën 10.000 euro për këstin e parë, pasi, sikurse referohet më sipër, rezultoi se nuk provohej burimi i ligjshëm i krijimit. Gjithashtu, në këtë analizë financiare, Komisioni nuk përfshiu tërheqjen e shumës 400 USD nga llogaria personale e subjektit pranë “Raiffeisen Bank”. Subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës²² se zotëron depozitë pa afat në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 401,09 USD, por kjo depozitë, si depozitimi i shumës edhe tërheqja e saj, nuk u konfirmuan nga “Raiffeisen Bank”²³.

Tabela nr. 1

Nr.	Përshkrimi	Viti 2007
1	TË ARDHURA	3,289,681
	Të ardhura nga paga, subjekti	871,481
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	-
	Kursime familjare, bashkëshorti, për këstin e parë të apartamentit	-
	Kredi NGB (20.000 euro), datë 28.9.2007	2,418,200
2	SHPENZIME	455,385
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	273,240
	Shpenzime kredia (principal + interes)	32,145
	Shpenzime arsimimi, bashkëshorti	150,000
3	PASURI	3,624,186
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Apartament me sip. 78 m ² aktmarrëveshje datë 16.8.2007	3,627,300
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(3,114)</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	-789,890

1.9.10 Komisioni, pas përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se dukej se: (a) subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare në shumën 789.890 lekë të investojë në këtë pasuri, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare; (b) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë për vitin 2007, pasi nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këstit të parë prej 10.000 euro, duke i kaluar barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9.11 Lidhur me këtë konstatim të Komisionit, subjekti ka parashtruar se familjarët e të fejuarit kanë pasur të ardhura për të mbuluar shumën 10.000 euro, dhuruar djalit të tyre për blerjen e apartamentit, pavarësisht faktit që nuk rezultojnë të ardhura për të cilat janë paguar tatimet. Në shpjegimet e saj, subjekti, për të provuar të ardhurat e familjarëve të bashkëshortit (të fejuarit në atë kohë), depozitoi dokumentacionin kopje të diplomës në degën e infermierisë si ndihmësmjek të babait të bashkëshortit, ku sipas subjektit ky i fundit e ka ushtruar punën si ndihmësmjek jo vetëm në shtet, por edhe privatisht, siç edhe vazhdon ta kryejë aktualisht. Po ashtu, subjekti ka parashtruar se nëna e bashkëshortit ka punuar në ish-Ndërmarrjen Artistike Vlorë dhe vazhdimisht ka punuar në banesë punime artistike (sixhade, qilima), të cilat i ka tregtuar dhe ka siguruar fitime të konsiderueshme, duke qenë se qyteti i Vlorës ka një numër të lartë turistësh gjatë gjithë vitit.

²² Depozituar më 30.3.2006.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 3.9.2020.

Halla e bashkëshortit ka qenë financiere e lartë dhe u ka ofruar konsulencë ekonomike shumë shoqërive (kryerje bilancesh). Subjekti ka shpjeguar se bashkëshorti ka kryer punë të ndryshme, sekretar pranë Shoqatës Kombëtare të Minifutbollit, agjent shitjesh, banakier, si dhe punëtor pranë një kompanie bastesh, fakt i deklaruar edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008.

1.9.12 Në qëndrimin e saj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se duke qenë se asnjë prej familjarëve të bashkëshortit nuk ka qenë subjekt deklarues, nuk kishin arsye objektive të ruanin faturat e veprimtarisë tregtare, të ardhurat objekt hetimi i përkasin një kohe para 20 vjetësh, gjatë së cilës bashkëshorti nuk ka qenë as në një marrëdhënie njohjeje me të.

1.9.13 Në vijim, subjekti ka kontestuar analizën financiare të Komisionit, duke pretenduar se diferenca e nxjerrë vjen në kundërshtim me rrethanat faktike, pasi shpenzimet e jetesës të llogaritura janë më të larta se të ardhurat e krijuara gjatë së njëjtës periudhë, kjo edhe për faktin se familjarët e bashkëshortit, përveçse kanë mbuluar shpenzimet e jetesës me të ardhurat e siguruara, kanë pasur edhe likuiditetet bankare vazhdimisht gjatë periudhës deri në vitin 2007. Në kohën që janë krijuar këto të ardhura subjekti nuk ka qenë e martuar me shtetasin K.Z dhe se shuma 10.000 euro ka qenë pasuri para martesë. Pra, subjekti nuk ka qenë pjesë e bashkësisë ligjore ku palët në këtë periudhë kanë vepruar në autonomi të plotë. Në këtë drejtim, subjekti ka theksuar se nuk ka asnjë dyshim apo informacion që bashkëshorti apo familjarë të tij të kenë kryer veprimtari të kundërligjshme dhe këto të ardhura të kenë burim këtë veprimtari, duke referuar edhe vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. *** dhe nr. ***, paragrafi 24.1.

1.9.14 Po ashtu, subjekti ka kontestuar analizën financiare për vitin 2007, duke kërkuar që nga ana e Komisionit:

a) Duhet të merret në konsideratë shuma 10.000 euro sipas dokumentacionit që ka paraqitur dhe një vlerësimi objektiv të kryer për rrethanat e paraqitura.

b) Duhet të zvogëlohen shpenzimet e jetesës, pasi deri në shtator të vitit 2007 ka jetuar me prindërit e saj dhe nga shtatori 2007 deri në gusht të vitit 2008 ka filluar të jetojë tek prindërit e bashkëshortit dhe, për rrjedhojë, shpenzimet jetike gjatë vitit 2007 deri në gusht të vitit 2008 i ka përballuar vetë, për sa i përket nevojave të saj personale.

c) Duhet të përlllogariten shpenzimet jetike për një person, pasi në vitin 2007 nuk ka qenë e martuar dhe gjatë jetesës në shtëpinë e prindërve të bashkëshortit kanë qenë këta të fundit që i kanë mbuluar shpenzimet për djalin e tyre dhe, në këto rrethana, subjekti ka parashtruar se ka përballuar vetëm shpenzimet e saj personale dhe, për rrjedhojë, shpenzimet jetike duhet të jenë për një person ($273.240:2 = 136.620$ lekë).

ç) Duhet të rillogariten shpenzimet e arsimit të bashkëshortit në vitin 2007, të cilat sipas subjektit nuk duhet të llogariten si të tilla, pasi bashkësia ligjore në këtë vit nuk kishte lindur, si dhe bazuar në deklaratën periodike të personit të lidhur me subjektin për vitin 2007 (pavarësisht se është plotësuar gabim prej tij pasi bashkëshorti është bërë person i lidhur në vitin 2008, pikërisht kur është lidhur martesë e tyre ligjore, datë 21.1.2008), shpjegohet që për këtë vit pagesa për shpenzimet për arsim ka qenë 0 (zero). Lidhur me këtë situatë, subjekti ka parashtruar se shpenzimet për shkollim në analizën e vitit 2007 në masën 150.000 lekë nuk duhet të përfshihen, pasi ato janë likuiduar në vitet 2005 dhe 2006. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2022, nga universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë. Sipas subjektit, detyrimi për arsim i bashkëshortit rrjedh nga vazhdimi i degës së dytë në universitet për vitet 2005 – 2009, ku në vitin 2007 tarifa për shkollim ka ndryshuar duke u

zvogëluar nga 150.000 lekë në 80.000 lekë për vit akademik, kjo sipas udhëzimit nr. 13, datë 28.5.2007, të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave.

d) Në lidhje me konstatimin e Komisionit për mosdeklarimin prej bashkëshortit të burimit të pagesës së këstit të parë prej 10.000 euro në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti ka shpjeguar se kjo pasaktësi rezulton në deklaratë periodike, e cila është plotësuar në shpjegimet që ka dhënë në ILDKPKI në datën 18.12.2008, me anë të procesverbalit të mbajtur²⁴, ku ka deklaruar: “Shlyer nga i fejuari im në shumën 10.000 euro me burim të ardhura të përfituara nga puna në eurofoto Vlorë dhe të ardhura të përfituara nga prindërit”. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se kjo pasaktësi nuk është mbartur në deklaratën *Vetting*, në të cilën ajo ka sqaruar burimin e kësaj shume.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

1.9.15 Trupi gjykues, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni, sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore – arsyeton si vijon:

1.9.16 Lidhur me çështjen e mosdeklarimit të burimit të këstit të parë 10.000 euro në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 prej bashkëshortit, trupi gjykues çmon se bazuar në certifikatën e martesës të depozituar nga subjekti me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, rezulton se subjekti është martuar në datën 21.1.2008 dhe, për rrjedhojë, në këtë vit i ka lindur detyrimi ligjor si subjekt deklarues për personin e lidhur me të, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë,” i ndryshuar. Pavarësisht këtij konstatimi ligjor, trupi gjykues, nisur nga fakti se subjekti e ka deklaruar këtë burim në deklaratën *Vetting*, si dhe në procesverbalin pranë ILDKPKI-së në vitin 2008, çmon se mosdeklarimi i burimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007 nga subjekti i rivlerësimit, mbetet një pasaktësi, që në raport me deklaratimet e tjera nuk ngrihet në nivelin e shkakut ligjor për penalizimin e subjektit.

1.9.17 Lidhur me ligjshmërinë e burimit në shumën 10.000 euro, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk provoi me dokumentacion ligjor të ardhurat nga punësimi në Shoqatën Kombëtare të Minifutbollit të bashkëshortit të saj. Po ashtu, edhe pretendimi tjetër i subjektit për të ardhurat nga punësimi i familjarëve të bashkëshortit (i fejuari në atë kohë), mbetet në nivel deklarativ dhe, për rrjedhojë, çmon se rezultati i hetimit administrativ për këtë çështje nuk ndryshon.

1.9.18 Gjithashtu, trupi gjykues, pretendimet e subjektit se këto janë të ardhura të krijuara para martesë dhe se i përkasin një kohe para 20 vjetësh, ku asnjë prej familjarëve të bashkëshortit nuk ka qenë subjekt deklarues, i ka vlerësuar referuar detyrimin ligjor që kanë subjektet e rivlerësimit sipas nenit D, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, në raport me pasojat që sjell mosprovueshmëria e kësaj të ardhure në procesin e rivlerësimit të saj. Në këtë drejtim, trupi gjykues konstaton faktet se: (i) pasuria apartament është në pronësi të subjektit dhe personit të lidhur me të; (ii) zotëron në mënyrë të vazhdueshme këtë pasuri; (iii) është një pasuri e deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe, si e tillë, ka detyrimin ligjor të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të saj. Pretendimet e subjektit sa më sipër trupi gjykues i vlerëson mbi relevancën që ato marrin në

²⁴ Subjekti ka referuar vendimin nr. ***, të Kolegjit, që procesverbali i mbajtur pranë ILDKPKI-së është vlerësuar si një dokument zyrtar, në kuptim të nenit 49, pika 1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

raport me cenimin e kriterit të pasurisë apo procesit tërësor të rivlerësimit, sikurse do të arsyetohet në vijim.

1.9.19 Për sa i takon çështjes së pamjaftueshmërisë financiare në shumën 789.890 lekë për vitin 2007, për efekt të analizës financiare të vitit 2007, Njësia e Shërbimit Ligjor kreu ripërlllogaritjet përkatëse për pretendimet që u morën në konsideratë, duke u reflektuar në analizën financiare.

a) Për vitin 2007 u përlllogaritën shpenzimet e jetesës vetëm për një person, për rrjedhojë janë hequr shpenzimet e bashkëshortit, pasi rezultoi e provuar se martesë ligjore e subjektit me bashkëshortin është lidhur më 31.1.2008. Vlerësohen të arsyeshme deklaratimet e subjektit në pyetësorin standard dhe në prapësime, që shpenzimet e jetesës të përlllogariten vetëm për të, pasi ajo nuk mund të ketë mbuluar të gjitha shpenzimet e familjarëve të të fejuarit në atë kohë, për sa kohë që edhe ata kanë qenë në marrëdhënie punësimi.

b) Nuk u mor në konsideratë shuma 10.000 euro sipas arsyetimit vlerësues të bërë në pikat 1.9.17-1.9.18 të këtij vendimi.

1.9.19.1 Për sa më sipër konsideruar/arsyetuar, trupi gjykues çmon se për vitin 2007 subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultojnë me diferencë të pajustificuar me burime të ligjshme me një balance negative prej 503.270 lekësh.

1.9.20 Në lidhje me shumën 20.000 euro, kredi bankare

1.9.21 Nga hetimi²⁵ i Komisionit për këtë burim ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë marrë një kredi me kontratën nr. ***, datë 26.9.2007 me palë kredimarrëse Banka Kombëtare e Greqisë (sot ABI Bank), palë kredimarrëse Vjola Canaj e K.Z dhe palë dorëzanëse L.Z, H.Z dhe H (H) Z. Kredia rezultoi në shumën 20.000 euro me qëllim blerje apartamenti në lagjen “***”, Vlorë. Kjo kredi është marrë për një afat 20-vjeçar dhe si kolateral është vendosur pasuria e llojit “apartament” në bashkëpronësi të shtetasve L.Z, H.Z dhe H (H) Z. Kolaterali i vendosur vërtetohet me kontratën e hipotekës nr. ***, datë 26.9.2007.

1.9.22 Nga verifikimi i *statement*-it rezultoi se kredia është disbursuar në datën 28.9.2007 në vlerën 20.000 euro. Pas disbursimit të saj dhe mbajtjes së komisioneve përkatëse nga banka, në datën 1.10.2007 është transferuar shuma 19.500 euro në llogarinë e shoqërisë “K” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti nga K.Z, Vjola Canaj”.

- Trupi gjykues, referuar fakteve të dala më sipër, çmon se nuk rezultojnë problematika apo dyshime lidhur me këtë burim krijimi/kredia si këst i dytë i blerjes së pasurisë apartament.

1.9.23 Në lidhje me shumën 2.500 euro si këst i tretë i kësaj pasurie, përballuar nga subjekti i rivlerësimit

1.9.24 Lidhur me këtë shumë, Komisioni kreu analizën financiare nëse subjekti kishte mundësi të kursente këtë shumë deri në datën 7.5.2008, kur është kryer pagesa, sikurse rezultoi në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2

Nr.	Përshkrimi	Datë 7.5.2008
1	TË ARDHURA	197,195
	Të ardhura nga paga, subjekti	197,195

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2020, nga ABI Bank, aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së.

2	SHPENZIME	195,723
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	113,850
	Shpenzime kredia (principal + interes)	81,873
3	PASURI	358,194
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Kësti i tretë për blerje apartamenti (2.500 euro, datë 7.5.2008)	307,956
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	50,238
	DIFERENCA (1-2-3)	-356,722

1.9.25 Komisioni, pas përlogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se dukej se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi financiare²⁶ në shumën 356.722 lekë, të paguajë këstin e tretë të kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet e tjera familjare.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.9.26 Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se gjatë periudhës së deklarimit nga shtatori i vitit 2007 deri në gusht 2008 ka jetuar në një shtëpi me prindërit dhe hallën e bashkëshortit dhe se shpenzimet e jetesës së bashkëshortit për këtë periudhë i kanë mbuluar këta të fundit, fakt i deklaruar prej saj edhe në pyetësin nr. 1.

1.9.27 Sipas subjektit, në përballimin e kësaj shume kanë shërbyer: (a) kursimet e saj nga vitet e mëparshme prej të ardhurave nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe nga puna si gjyqtare në Durrës dhe Vlorë dhe duke pasur parasysh shpenzimet kanë qenë minimale pasi ka jetuar me prindërit, porse nuk i ka deklaruar si gjendje *cash*, pasi ka pasur paqartësi në plotësimin e deklaratës; (b) tërheqja e depozitës pranë “Raiffeisen Bank” në vlerën 400 USD, e cila duhet të përfshihet në analizën financiare, pasi sipas subjektit kjo depozitë nuk del në sistemin e bankës për arsye se ka qenë e hapur në kohën kur kjo bankë quhej Banka e Kursimeve dhe se nga ana e saj është deklaruar rregullisht si në deklaratën para fillimit të detyrës, të depozituar më 30.3.2006, ashtu edhe në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 kur kjo depozitë është mbyllur. Në konkluzion subjekti ka parashtruar se në rast se nga ana e Komisionit do të llogariteshin në pagimin e këtij kësti kursimet e mundshme faktike dhe do të zbriteshin shpenzimet sipas deklarimit të saj, atëherë rezultati edhe në pagimin e këtij kësti do të rezultonte pozitiv.

1.9.28 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit në raport me faktet e konstatuara, vlerëson se pretendimi për përfshirje në analizën financiare të shumave *cash* të disponuara si kursime nga vitet e kaluara nuk mund të merret në konsideratë, për sa kohë nuk rezultojnë të deklaruara si të tilla në deklaratën periodike përkatëse. Gjithashtu, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë as vlerën 400 USD, pasi nga ana e subjektit nuk u provua me dokumentacion mbështetës. Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk justifikojnë me burime financiare të ligjshme pagesën e këstit të tretë të kësaj pasurie, në shumën -356.722 lekë, por e konsideron këtë vlerë të pamjaftueshme si shkak autonom, për të konsideruar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

1.10 Detyrimet financiare

²⁶ Duke i kaluar barrën e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

1.10.1 Kredi bankare midis “National Bank of Greece” dhe shtetasve Vjola Canaj dhe K.Z, në cilësinë e kredimarrësve, si dhe tre persona të shënuar në rubrikën e të dhënave konfidenciale, në cilësinë e dorëzanësve, për shumën 20.000 euro, me datë fillimi 26.9.2007 dhe datë mbarimi 5.10.2027, me nr. kontrate ***, datë 26.9.2007, me interes 5%, me afat 20 vjet, dhe këst mujor 141,83 euro/muaj. Detyrimi i mbetur është 13.405,94 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentacionin përkatës²⁷.

1.10.2 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, shprehet: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ardhur nga NBG-ja.*

Hetimi i Komisionit

1.10.3 Subjekti i rivlerësimit e deklaroi këtë kredi në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, me përshkrimin “kredi për shtëpi në shumën 20.000 euro, me kredidhënës Bankën Kombëtare të Greqisë”.

1.10.4 Nga korrespondenca e Komisionit me ABI Bank²⁸ (ish-NBG) konfirmohet kredia e disbursuar në datën 28.9.2007 në vlerën 20.000 euro. Pas disbursimit, shuma 19.532 euro është transferuar në datën 1.10.2007, me përshkrimin “pagesë për blerje apartamenti nga K.Z, Vjola Canaj për ‘K’ sh.p.k.”.

1.10.5 Nga analizimi i *statement*-it konfirmohet detyrimi i mbetur deri më 30.1.2017, i cili është në vlerën 14.409,07 euro.

1.10.6 Komisioni, në analizë të të dhënave të dala për këtë kredi, konstaton se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e ardhur nga ABI Bank për vlerën e mbetur të kësaj kredie deri në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting*.

1.11 Në rubrikën “të dhëna konfidenciale” ka rezultuar se subjekti ka deklaruar shtetasit L.Z, H.Z dhe H.Z kanë hyrë si dorëzanës në kontratën e kredisë bankare midis “National Bank of Greece” dhe shtetasve Vjola Canaj e K.Z si dhe kanë hipotekuar si hipotekë të nivelit të dytë në favor të bankës për sigurimin e pagimit të kredisë pasurinë në bashkëpronësi të tyre nr. ***, të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme vol. ***, f. ***, të ndodhur në z. k. ***, Vlorë. Numër i regjistrat publik për pasurinë e hipotekuar si garanci për kredinë ***, vol. ***, f. ***, ndodhur në z. k. nr. ***, Vlorë. Kontrata noteriale e kredisë dhe dorëzimit nr. ***, datë 26.9.2007, mbajtur tek notere I.B. Kontrata noteriale e hipotekës nr. ***, datë 26.9.2007, mbajtur tek notere I.B.

Komisioni ka konstatuar se shtetasit e deklaruar janë dorëzanës në kredinë e marrë për blerjen e pasurisë apartament e trajtuar/arsyetuar më sipër.

❖ Deklarimi i pasurive të bashkëshortit të subjektit, z. K.Z

1.12 Shtëpi banimi me sip. 78 m², me adresë: lagjja “****”, Vlorë, ndërtuar në vitin 2008, me çmimin 32.000 euro, paguar 32.000 euro, me pjesë takuese 50% Vjola Canaj dhe 50% K. Z, kaluar në pronësi me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.1.2017. Shuma 20.000 euro, marrë hua nëpërmjet kredisë bankare të deklaruar.

²⁷ Kontratë kredie nr. ***, datë 26.9.2007, me palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë, palë kredimarrëse Vjola Canaj e K.Z, palë dorëzanëse L, H dhe H.Z, për marrje kredi në shumën 20.000 euro, me qëllim blerje apartamenti në lagjen “****”, Vlorë. Si kolateral vendoset pasuria nr. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi të shtetasve H, L dhe H.Z + kartelë pasurie për apartament me sip. 77 m², nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, Vlorë, në bashkëpronësi të shtetasve H, L dhe H.Z (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së); vërtetim datë 24.1.2017, e NBG Bank, ku vërtetohet se shtetasit Vjola Canaj dhe K.Z kanë marrë kredi për blerje shtëpie në shumën 20.000 euro prej datës 29.9.2007. Balanca e kredisë në datën 24.1.2017 është 13.405 euro. Klientët paguajnë një këst prej 141,83 euro (aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.8.2020.

1.12.1 Komisioni ka konstatuar se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të njëjtën pasuri si në deklarin e subjektit të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, vlerëson të mos bjerë në përsëritje në trajtimin/arsyetimin ligjor të saj.

1.13 Automjet tip “Daimler Chrysler c 220” (4+1), nr. vin ***, me targa ***, vit i prodhimit 2003, ngjyrë gri, me numër të lejes së qarkullimit ***, lëshuar në datën 11.6.2012. Kontrata e blerjes nr. ***, datë 18.5.2012. Vlera: 3.000 euro. Bashkëshorti i subjektit zotëron 100% të së drejtës së pronësisë mbi automjetin. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁹.

1.13.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj ka konstatuar: *Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRR-ja.*

Hetimi i Komisionit

1.13.2 Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e deklaroi këtë pasuri të luajtshme për herë të parë në DPV-në e vitit 2012, me përshkrimin: “Automjet e tipit ‘Daimler Chrysler’, tipi c 220, blerë me anë të kontratës nr. ***, datë 18.5.2012”. Vlera e blerjes së këtij automjeti është 3.000 euro.

1.13.3 Nga hetimi i Komisionit konstatohet se bashkëshorti i subjektit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe as në deklaratën *Vetting*.

1.13.4 DPSHTRR-ja³⁰ konfirmon se shtetasi K.H.Z ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***. Kjo drejtori ka vendosur në dispozicion kontratën e shitjes (pasuri e luajtshme) nr. ***, datë 18.5.2012, me palë shitëse shtetasin E.H dhe palë blerëse shtetasin K.Z, të automjetit tip “Daimler Chrysler C220”, me targa ***, në vlerën 3.000 euro. Këtë automjet rezultoi që bashkëshorti i subjektit e ka shitur në vitin 2019.

1.13.5 Komisioni e ka pyetur³¹ subjektin lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, e cila, në përgjigje, ka deklaruar se: *“Burimi i krijimit të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti kanë qenë të ardhurat nga pagat e bashkëshortit dhe të miat përgjatë vitit 2012”.*

1.13.6 Komisioni kreu analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat e bashkëshortëve për vitin 2012 deri në datën e investimit, të paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3

Nr.	Përshkrimi	Datë 18.5.2012
1	TË ARDHURA	555,817
	Të ardhura nga paga, subjekti	327,382
	Të ardhura nga paga, bashkëshorti	228,435
2	SHPENZIME	328,363
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	158,652
	Shpenzime kredia (principal + interes)	92,865

²⁹ Vërtetim datë 19.1.2017, e DRSHTRR-së Vlorë, ku vërtetohet se shtetasi K.Z ka në pronësi automjetin me targa ***, të llojit “Daimler Chrysler”, vit prodhimi 2003. Kurse automjeti me targa ***, tip “Mercedes-Benz”, vit prodhimi 1987, është çregjistruar përfundimisht në datën 19.1.2017; vërtetim datë 19.1.2017, i DRSHTRR-së Vlorë, ku vërtetohet se automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, është hequr përfundimisht nga qarkullimi në datën 19.1.2017 për arsye jashtë përdorimi (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 19.8.2020.

³¹ Pyetësor nr. 3, datë 6.10.2022.

	Shpenzime TIMS	76,846
3	PASURI	394,310
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme	
	Automjet “Daimler Chrysler”, kontratë nr. ***, datë 18.5.2012 (***)	419,160
	<i>Ndryshim likuiditeti</i>	<i>(24,850)</i>
	DIFERENCA (1-2-3)	-166,856

1.13.7 Komisioni, pas përlllogaritjeve të kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konstatoi se: (a) duket se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti nuk kanë pasur mundësi financiare në shumën 166.856 lekë të investojnë në blerjen e këtij automjeti, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare; (b) bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe atë *Vetting* dhe, për rrjedhojë, i kaloi barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.13.8 Në qëndrimin e saj subjekti ka parashtruar se të ardhurat për blerjen e këtij automjeti kanë ardhur si rezultat i kursimeve me të ardhura nga pagat bashkëshortore gjatë vitit 2012. Subjekti ka pretenduar se pagesa e çmimit për këtë pasuri është kryer përgjatë vitit 2012, pavarësisht se në kontratën e shitjes është pasqyruar e likuiduar, për arsye se bashkëshorti i saj me shitësin e automjetit janë shokë fëmijërie dhe nuk kanë pasur probleme në lidhje me mënyrën e pagesës.

1.13.9 Në vijim, subjekti ka kontestuar analizën financiare të Komisionit të lidhura me disa shpenzime *TIMS* dhe bileta udhëtimi të deklaruara nga ana e saj të paguara nga motra e bashkëshortit dhe kunati i tij (provuar me anë të biletave të printuara me emrin e personit që i ka paguar, si dhe konfirmimi i biletës në *e-mail*-in ***, shpenzime këto që sipas subjektit duhet të konsideroheshin me kosto 0 (zero) ose ne rastin më të keq të ngarkohen me vlerën e pasqyruar në biletën e datës 16.1.2012³². Subjekti ka referuar si rast të ngjashëm vendimin nr. *** të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

1.13.14 Trupi gjykues, në analizë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me faktet e konstatuara, vlerëson se pretendimi i subjektit lidhur me faktin se çmimi i blerjes së automjetit është likuiduar përgjatë vitit 2012, edhe pse në kontratën e shitjes është pasqyruar e likuiduar, nuk merret në konsideratë, për sa kohë që nuk provohet e kundërta me ndonjë dokumentacion justifikues. Komisioni i qëndron kontratës së shitjes që vlera është likuiduar, pavarësisht faktit se analiza vjetore e vitit 2012 rezulton pozitive.

1.13.15 Lidhur me pretendimet e subjektit për shpenzimet e udhëtimeve jashtë vendit, Komisioni vlerëson se objektivisht ky pretendim duhet të merret në konsideratë vetëm për ato udhëtime që nga ana e saj janë depozituar biletat e udhëtimit, ku referohen çmimet e tyre, duke i ripërlllogaritur në analizën financiare sipas çmimit të biletave.

1.13.16 Trupi gjykues, për efekt të analizës financiare të vitit 2012 pas ripërlllogaritjeve përkatëse, duke çmuar efektet e rivlerësimit, për sa është arsyetuar më sipër, konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk justifikojnë me burime financiare të ligjshme blerjen e këtij automjeti, si dhe të përballojnë shpenzimet e tjera familjare në shumën -140.597 lekë, duke

³² Referohuni dokumentacionin e depozituar pranë Komisionit me nr. ***, datë 24.10.2022 (përgjigjet e pyetësorit nr. 3).

konkluduar se subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, geramat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016.

1.13.17 Trupi gjykues, i udhëhequr nga parimi i objektivitetit dhe proporcionalitetit, në përputhje me standardet e vendosura nga jurisprudenca e deritanishme e Kolegjit³³, vlerëson se mungesa e burimeve të ligjshme nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për të justifikuar blerjen e automjetit tip “Daimler Chrysler”, është jodomethënëse për vlerësimin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit dhe nuk mund të ngrihet në nivelin e një shkaku shkarkimi.

Detyrimet financiare

1.14 Kredi bankare midis “National Bank of Greece” dhe shtetasve Vjola Canaj dhe K.Z, në cilësinë e kredimarrësve, si dhe tre persona të shënuar në rubrikën e të dhënave konfidenciale në cilësinë e dorëzanësve, për shumën 20.000 euro. Data e fillimit 26.9.2007 dhe data e mbarimit 5.10.2027, nr. i kontratës ***, datë 26.9.2007, me interes 5%, me afat 20 vjet dhe këst mujor 141,83 euro/muaj. Detyrimi i mbetur:13.405,94 euro.

1.15 Ka rezultuar se në rubrikën “të dhëna konfidenciale” bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se shtetasit L.Z, H.Z dhe H.Z, hyrë si dorëzanës në kontratën e kredisë bankare midis “National Bank of Greece” dhe shtetasve Vjola Canaj e K.Z, si dhe kanë hipotekuar si hipotekë të nivelit të dytë në favor të bankës për sigurimin e pagimit të kredisë pasurinë në bashkëpronësi të tyre nr. ***, të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme vol. ***, f. ***, të ndodhur në z. k. ***, Vlorë. Numër i regjistrit publik për pasurinë e hipotekuar si garanci për kredinë nr. ***, vol. ***, f. *** të ndodhur në z. k. ***, Vlorë. Kontrata noteriale e kredisë dhe dorëzanisë nr. ***, datë 26.9.2007, mbajtur tek notere I.B. Kontrata noteriale e hipotekës nr. ***, datë 26.9.2007, mbajtur tek notere I.B.

- Komisioni ka konstatuar se kredia bankare pranë “National Bank of Greece”, si dhe shtetasit e deklaruar si dorëzanës në kredinë e marrë për blerjen e pasurisë apartament, referojnë të njëjtin deklaram si subjekti i rivlerësimit, trajtuar/arsyetuar në këtë vendim.

1.16 Derdhje në llogari nga shtetasi S.SH në “Raiffeisen Bank”, me datë 23.11.2011, me qëllim dhënien e kësaj shume të atit S.SH. Deklaratë noteriale e shtetasit S.SH për marrjen e kësaj shume. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017, pranë noteres V.M. Derdhje në llogari nga shtetasi S.SH në “Raiffeisen Bank”, me datë 1.12.2011, me qëllim dhënien e kësaj shume të atit S.SH. Deklaratë noteriale e shtetasit S.SH për marrjen e kësaj shume. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017, pranë noteres V.M. Derdhje në llogari nga shtetasi S.SH në “Raiffeisen Bank”, me datë 30.12.2011, me qëllim dhënien e kësaj shume të atit S.SH. Deklaratë noteriale e shtetasit S.SH për marrjen e kësaj shume. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017, pranë noteres V.M. Derdhje në llogari nga shtetasi S.SH në “Raiffeisen Bank”, me datë 24.1.2011, me qëllim dhënien e kësaj shume të atit S.SH. Deklaratë noteriale e shtetasit S.SH për marrjen e kësaj shume. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017, pranë noteres V.M. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente³⁴.

³³ Referohuni vendimeve nr. 31/2020 (JR) dhe nr. 18/2021 (JR) të Kolegjit.

³⁴ Nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank” për z. K.Z, ku rezulton se shtetasi S.SH ka kredituar shumat si vijon: datë 23.11.2011 – 73.000 lekë; datë 1.12.2011 – 88.000 lekë; datë 9.1.2012 – 93.500 lekë; datë 24.1.2012 – 42.700 lekë, shuma të cilat janë tërhequr një ditë më pas (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

Deklaratë noteriale nr. ***, datë 26.1.2017, ku shtetasi S.SH deklaroi se: “Në llogarinë e K.Z në ‘Raiffeisen Bank’ janë derdhur nga vëllai im S.SH për llogari time shumat si vijon: në datën 23.11.2011 është derdhur shuma 73.000 lekë; në datën 1.12.2011 shuma 88.000 lekë; në datën 9.1.2012 shuma 93.500 lekë; dhe në datën 24.12.2012 shuma 42.700 lekë, shuma që pikërisht në këto data më janë dorëzuar cash nga K.Z” (aneks nr. *** në dosjen e ILDKPKI-së).

1.16.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, ka konstatuar: *Përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.*

Hetimi i Komisionit

1.16.2 Nga hetimi³⁵ rezulton se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Raiffeisen Bank” dhe “Tirana Bank” janë kryer disa depozitime nga shtetasi S.SH. Shumat e depozituara janë tërhequr nga bashkëshorti pothuajse një ditë më vonë.

1.16.3 Komisioni e ka pyetur³⁶ subjektin lidhur me këto transaksione, e cila, në përgjigje të saj, ka shpjeguar se: *“...shumat janë derdhur në llogarinë e bashkëshortit tim, me qëllim dorëzimin e tyre të atit të personit që kishte kryer derdhjen. Me ane të deklarats noteriale me nr. ***, datë 26.1.2017, kam provuar së këto shuma i janë dorëzuar vëllait të dërguesit, S.SH, me qëllim dhënien e kësaj shume kryefamiljarit. Në asnjë rast nuk ka pasur ndonjë pretendim nga ndonjë anëtar i familjes Shyti se kjo shume nuk i është dorëzuar vëllait të dërguesit, shtetasit S.SH. Për të sqaruar lidhjen e bashkëshortit tim me S dhe S.SH, dua të theksoj se me S bashkëshorti është shok prej shkollës së mesme dhe me pas edhe marrëdhënie krushqie...*

*Për sa i përket burimit të krijimit të këtyre të ardhurave, nga ana e shtetasit S.SH më ka deklaruar se kanë qenë të ardhura nga biznesi familjar që këta të fundit kanë pasur që prej vitit 1992. Bashkëlidhur deklarata noteriale nr. ***, datë 4.10.2022, e S.SH dhe vërtetimi i lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve Vlorë, që provon së në emër të nënës së S.SH në datën 1.1.1992 është regjistruar një aktivitet biznesi që ka vazhduar deri në datën 26.7.2022”.*

1.16.4 Komisioni, lidhur me këto transaksione, në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti, ka konstatuar se për sa kohë përgjatë hetimit provohet se këto shuma në vlera jo të konsiderueshme nuk rezultojnë të jenë pretenduar si të ardhura apo të jenë përdorur si burim krijimi për ndonjë pasuri, duke mos përfshirë ato në analizën e kryer, çmon se nuk ka dyshime në lidhje me to dhe i konsideron bindëse shpjegimet e subjektit.

❖ Gjetje të tjera

1.17 Nga korrespondenca e Komisionit me institucionet publike³⁷ si AMF, Policia e Shtetit për hyrje-daljet dhe Ministria e Drejtësisë për regjistrin noterial, nuk kanë rezultuar problematika apo dyshime për përdorim automjetesh, dalje në *TIMS* me automjete të padeklaruara apo kontrata të nënshkruara pranë noterit publik nga dhe në adresë të subjektit të rivlerësimit, përveçse atyre të identifikuara gjatë hetimit.

1.18 Lidhur me huan në vlerën 60.000 lekë, të marrë nga bashkëshorti i subjektit në vitin 2009 dhe shlyer në vitin 2010, Komisioni hetoi³⁸ mbi huadhënësin R.N. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, por nisur edhe nga vlera e papërfillshme e marrë hua, pothuajse sa vlera e pagës mujore (sipas llogarive bankare), Komisioni nuk konstatoi ndonjë problematikë për dhënien e kësaj shume.

1.19 Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar në deklarats Vetting llogaritë bankare, duke i kërkuar subjekti të japë shpjegime lidhur me mosdeklarimin e tyre, siç referohet në vijim:

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 3.9.2020, nga “Raiffeisen Bank”.

³⁶ Pyetësor nr. 2, datë 15.9.2022.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.8.2020, nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare; shkresë nr. *** prot., datë 17.8.2020, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; shkresë nr. *** prot., datë 13.8.2020, nga Ministria e Drejtësisë.

³⁸ Hetimi i përgjithshëm për personin e lidhur, në dosjen e Komisionit.

1.19.1 “Tirana Bank”³⁹ informon se subjekti rivlerësimi ka llogari page pranë kësaj banke me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 165.966,67 lekë.

1.19.2 BKT⁴⁰ informon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimi ka llogari page pranë kësaj banke me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 72.303,54 lekë.

1.19.3 “Raiffeisen Bank”⁴¹ informon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimi ka llogari pranë kësaj banke me gjendje në datën 27.1.2017 në vlerën 800.155,75 lekë. Kjo shumë është investuar në depozitë dhe vjen si rezultat i ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

1.19.4 Subjekti i rivlerësimi, në qëndrimin e saj, ka parashtruar se konstatimi i Komisionit rezulton i drejtë, porse kjo ka ndodhur për shkak të ngarkesës së madhe në atë kohë. Subjekti ka sqaruar se këto gjendje janë deklaruar të përfshira në zërin të ardhura në deklaratën *Vetting*, sipas çdo rasti, por nuk janë deklaruar si gjendje të mbetura në llogari në datën 27.1.2017. Po ashtu, subjekti parashtron se referuar inventarit justifikues shoqërues të dorëzuar së bashku me deklaratën *Vetting* në datën 27.1.2017, ajo ka depozituar të gjithë materialin justifikues në lidhje me gjetjen e Komisionit, fakt që tregon se nuk ka qenë qëllim fshehja, pasi janë depozituar dhe inventarizuar bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, dhe specifikisht: (i) vërtetim page nr. *** prot., datë 19.1.2017, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; (ii) nxjerrje llogarie nga BKT-ja, datë 24.1.2017; (iii) nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank” (bashkëshorti).

1.19.5 Trupi gjykues, lidhur me këtë çështje objekt vlerësimi, ka konstatuar se: (i) llogaria e subjektit është llogari page ku kreditohet paga e saj; (ii) gjendja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit është krijuar me të ardhura të cilat vijnë si rezultat i ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. ***, datë 21.11.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; (iii) provohet se subjekti ka depozituar dokumentacion në inventarin justifikues shoqërues të dorëzuar së bashku me deklaratën *Vetting* në datën 27.1.2017, pra, para se të fillonte procesi i rivlerësimi.

1.19.6 Për sa është konstatuar më sipër, trupi gjykues çmon se jemi përpara një pasaktësie në deklaram, e cila nuk vlerësohet se ka pasur për qëllim fshehjen e llogarive dhe, për rrjedhojë, konkludon se kjo pasaktësi nuk mund të shërbejë si shkak për të penalizuar subjektin e rivlerësimi.

1.20 Lidhur me analizën financiare për periudhën 2006 – 2016, Komisioni u bazua në të ardhurat e ligjshme sipas vërtetimeve për të ardhurat *neto*, lëshuar nga institucionet publike për subjektin e rivlerësimi dhe bashkëshortin e saj për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në zbatim të pikës 3, të nenit D të aneksit të Kushtetutës. Shpenzimet e jetesës, për vitet 2006 – 2016 u bazuan në shpenzimet e përcaktuara në raportin e ILDKPKI-së⁴², si dhe në shpenzimet e tjera të identifikuara gjatë hetimit, si pagesat e kësteve për kreditë apo investimi në blerje automjeti. Në analizën e kryer nuk janë përfshirë shpenzime mjekimi, duke u bazuar në dokumentacionin e depozituar⁴³ nga subjekti, ku diagnoza e saj është e përfshirë në sëmundjet e përjashtuara nga tarifimi. Faturat e depozituara janë me vlerë 0 (zero), për këtë arsye nuk janë përfshirë në analizën financiare. Për shpenzimet e arredimit, Komisioni ka vlerësuar që shpenzimin total të deklaruar nga subjekti prej 400.000 lekësh ta ndajë për dy vite në raportin 60% për vitin 2008 dhe 40% në vitin 2009, meqenëse subjekti ka filluar të banojë në këtë apartament në vitin 2008 dhe pjesa më e madhe e

³⁹ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.8.2020.

⁴⁰ Me shkresën nr. *** prot., datë 26.8.2020.

⁴¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 3.9.2020.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2019, nga ILDKPKI-ja.

⁴³ Pyetësor nr. 2, datë 15.9.2022 dhe pyetësor nr. 3, datë 6.10.2022.

shpenzimeve i takojnë këtij viti për një banesë të re. Shpenzimet e shkollimit për bashkëshortin dhe djalin u bazuan në deklaratimet periodike të subjektit, si dhe gjatë hetimit⁴⁴.

Në përfundim, rezultoi se përveç balancës negative në shumën 789.890 lekë në vitin 2007 dhe shumës 716.550 në vitin 2008 si më sipër arsyetuar, rezultonte se subjekti gjendej në balancë negative për vitin 2009 në shumën 4.585 lekë dhe në shumën 183.535 lekë për vitin 2013. Pra, në total, për periudhën e analizuar 2006 – 2016, dukej se subjekti rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj rezultonin në një balancë negative në shumën 1.694.560 lekë, për të investuar dhe përballuar shpenzimet përkatëse familjare, për të cilën Komisioni i kaloi barrën e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

1.21 Në qëndrimin e saj, subjekti ka kontestuar analizën finaciare për vitet 2007-2009 dhe 2013, konkretisht:

i) Lidhur me gjendjen negative të vitit 2007, ka parashtruar të njëjtat kontestime, pasqyruar në këtë vendim në pikat 1.9.11 - 1.9.14.

ii) Lidhur me gjendjen negative të vitit 2008, si vijon:

- Shpenzimet jetike duhet të llogariten në një masë më të vogël, pasi deri në muajin gusht të vitit 2008 ajo dhe bashkëshorti kanë jetuar në shtëpinë e prindërve të bashkëshortit dhe kanë qenë këta të fundit që i kanë mbuluar këto shpenzime. Si rrjedhojë e këtij fakti, subjekti pretendon që në zërin “shpenzimet për jetesë” bashkëshorti i saj duhet të mbajë një peshë prej 4 muajsh, ndërsa djali i tyre për një periudhë 10-mujore, pasi ka ardhur në jetë më 28.2.2008. Sipas subjektit, në analizë të llogaritjeve të shpenzimeve jetike për vitin 2008, duke pjesëtuar vlerën e ILDKPKI-së, sipas peshës së muajve për çdo person (subjekti për 12 muaj, djali atë të 10 muajve dhe bashkëshorti atë të 4 muajve, pra totali = 34 muaj), përfundimi sipas përlllogaritjeve rezulton $387.090/34 = 11.385 \times 26 = 296.010$ lekë, vlerë kjo që duhej të ishte shpenzim jetese për vitin 2008.

- Ka kontestuar ndarjen e shpenzimeve të mobilimit në shumën 400.000 lekë në dy vite, duke pretenduar një shpërndarje të këtij shpenzimi në vite, përgjatë gjithë periudhës, pasi në përgjigjen e pyetësorit të parë ka deklaruar se: *“Mobilimi i shtëpisë sonë ka filluar qysh prej vitit 2008 deri në ditët e sotme. Vlera e shpenzimeve për mobilim është afërsisht 400.000 lekë dhe është shtrirë gjatë gjithë kësaj periudhe”*. Sipas subjektit, shpenzimet për arredim duhej të ishin të shtrira në vite edhe pse mobilimi në shumën e shpenzuar është i përfshirë në anketën e buxhetit të familjes sipas INSTAT-it, *Klasifikimi i Konsumit Individual sipas Qëllimit (COICOP)* dhe nuk duhet të ishte zë më vete shpenzimesh për arredim.

- Shpenzimet për shkollimin e bashkëshortit për vitin 2008, në masën 240.000 lekë, nuk duhet të përfshihen në këtë vit, pasi ato janë likuiduar në vitet 2005 dhe 2006. Sipas subjektit, ky detyrim gabimisht i është ngarkuar asaj, pasi shpenzimet për arsim të bashkëshortit kanë filluar para martesës (në vitin 2005), ashtu si bashkëshorti i saj ka deklaruar në deklaratën fillestare të vitit 2008, për pasojë nuk kanë qenë pjesë e bashkësisë ligjore. Për të provuar këtë fakt subjekti ka depozituar shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 16.11.2022, nga universiteti “Ismail Qemali” Vlorë. Sipas subjektit, detyrimi për arsim i bashkëshortit rrjedh nga vazhdimi i degës së dytë në universitet për vitet 2005 – 2009 dhe se ky detyrim për arsim, duke qenë se ka lindur para martesës, bazuar në dispozitat e Kodit të Familjes nuk i përket bashkësisë ligjore dhe nuk mund

⁴⁴ Pyetësor nr. 1, datë 22.7.2020.

t'i ngarkohen subjektit të rivlerësimit, fakt i cili provohet edhe me deklarinimin në ILDKPKI në vitin 2008 në procesverbalin datë 18.12.2008, ku sërish ka deklaruar se këto detyrime nuk i përkasin asaj dhe nuk kanë të bëjnë me shpenzime të përbashkëta. Sipas subjektit rezulton se personi i lidhur në deklaratën e parë pas martesës ka deklaruar se i gjithë detyrimi i shlyer nga viti 2005 deri në momentin e deklarinimit ka qenë në masën 240.000 lekë dhe referuar të njëjtës deklaratë, në fund të vitit 2008 kishte mbetur pa shlyer vetëm vlera 80.000 lekë, e cila është shlyer gjatë vitit 2009. Ky përshkrim është bërë në këtë formë për arsye se ky ka qenë deklarimi i parë i bashkëshortit dhe, për këtë qëllim, ka deklaruar të gjitha detyrimet e shlyera për arsye të deklarinimit fillestar. Këto detyrime janë shlyer në masën 150.000 lekë për vitin akademik 2005 - 2006 dhe 90.000 kësti i semestrit të parë të vitit akademik 2006 - 2007. Më pas, me daljen e udhëzimit nr. 13, datë 28.5.2007, të Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave, ku detyrimi për tarifën e shkollimit në degë të dytë bëhej 80.000 lekë, sipas përlllogaritjeve të pagesave të kryera deri në atë moment, bashkëshortit i mbetej edhe vlera 80.000 lekë detyrim për shkollim, e cila është paguar në vitin 2009. Ky fakt provohet me deklaratën fillestare të vitit 2008 të bashkëshortit, i cili, në seksionin “detyrime financiare”, deklaroi se *totali i detyrimit të shlyer për studim 2005 – 2009 është 240.000 lekë dhe shuma e detyrimit financiar që ka mbetur 80.000 lekë*, duke rezultuar kështu që në deklaratën e vitit 2008 bashkëshorti i saj nuk ka deklaruar se këtë vit janë kryer shpenzime nga ana e tij.

iii) Lidhur me gjendjen negative të vitit 2009, subjekti ka kërkuar, sikurse edhe për vitin 2008, që shpenzimet e mobilimit të shpërndahen për të gjithë periudhën e deklarinimit. Po për këtë vit subjekti ka kontestuar edhe shpenzimet e sistemit *TIMS*, pasi, sikurse ka deklaruar edhe në pyetëtorin e tretë, bashkëshorti i saj nuk ka qenë asnjëherë në shtetin grek dhe ky shpenzim duhet të jetë 0 (zero) në tabelën e këtij sistemi. Subjekti ka sqaruar se për të provuar këtë fakt ka paraqitur pasaportën e tij me pyetëtorët gjatë hetimit administrativ. Në këtë rast, sipas subjektit, viti 2009 do të ishte me bilanc pozitiv në masën 117.874 lekë.

iv) Lidhur me gjendjen negative të vitit 2013, subjekti ka kontestuar konkretisht zërin “shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së”, sepse ka një dublim të tyre, pasi janë përfshirë edhe ditët e qëndrimit jashtë vendit për vitin 2013. Në këtë drejtim, sipas subjektit, rezulton që ajo ka 69 ditë qëndrimi jashtë vendit, bashkëshorti i saj 65 ditë qëndrimi jashtë vendit dhe djali i tyre 22 ditë qëndrimi jashtë vendit, ku shpenzimet jetike për këto ditë janë të përfshira te shpenzimet e sistemit *TIMS* dhe, për rrjedhojë, nuk duhet të përfshihen te shpenzimet jetike duke paraqitur edhe përlllogaritjet⁴⁵ përkatëse. Në vijim, subjekti ka kontestuar përlllogaritjet e ditëve të qëndrimit jashtë vendit për vitin 2013, që sipas subjektit duhej të ishin 32 ditë më pak për person, kjo për arsye se tri biletat e fundit që pasqyrohen nga Komisioni kanë datën e daljes në vitin 2013 dhe si datë hyrjeje mbajnë datën 1.2.2014. Po ashtu, në lidhje me udhëtimin turistik me *charter*, 7 ditët e qëndrimit të djalit, sipas subjektit, duhet të ishin pa kosto pasi ai ka qenë 5 vjeç, duke paraqitur edhe përlllogaritjet përkatëse sipas të dhënave ditë qëndrimi/numrin e personave/dhe kostot, duke referuar vendimin nr.***, datë 22.5.2019, të Kolegjit. Ka kontestuar mosmarrjen në konsideratë nga Komisioni të pagesave nga familjarët e saj të disa biletave të avionit, për të cilat ka parashtruar se nëse nga ana e Komisionit nuk pranohet njohja e këtyre shpenzime si të paguara nga familjarët, atëherë biletat e depozituara në pyetëtorin e tretë të pasqyrohen në tabelën e sistemit *TIMS* si shpenzime të subjektit, duke pasqyruar edhe përlllogaritjet⁴⁶ përkatëse.

⁴⁵Referohuni shpjegimeve të subjektit nr. *** prot., datë 17.11.2022, f. 20-22.

⁴⁶Referohuni f. 20-22 në materialin shpjegues të subjektit, me nr. ***prot., datë 17.11.2022.

1.22 Trupi gjykues, nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit në raport me pretendimet e subjektit për periudhën 2006 – 2016, pas verifikimeve dhe vlerësimeve të tyre, ka konstatuar efektet e rivlerësimit sa më poshtë rezulton:

1.22.1 Lidhur me analizën financiare të vitit 2007, Komisioni, në vlerësimin dhe arsyetimin e balancave negative në raport me pretendimin e subjektit për vitin 2007, i trajtoi dhe arsyetoi në pikat 1.9.15-1.9.19.1, duke vlerësuar të mos bjerë në përsëritje.

1.22.2 Lidhur me analizën financiare të vitit 2008, Komisioni vlerëson se:

- Pretendimi për reduktim të shpenzimeve të jetesës nuk qëndron, pasi ato janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare të subjektit të rivlerësimit, provuar kjo me certifikatën familjare. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur për dy persona (subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti) deri në shkurt të vitit 2008 dhe për 3 persona pas shkurtit të vitit 2008 (me lindjen e fëmijës së tyre).

- Pretendimi për shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit për periudhën 2008 – 2016 në mënyrë të barabartë, nuk merret në konsideratë, nga trupi gjykues, pasi vlerëson si të arsyeshme dhe objektive faktin se pjesa më e madhe e shpenzimeve të mobilimit i përkasin vitit të parë në momentin e hyrjes në një banesë të re. Trupi gjykues nuk e gjen të pranushëm këtë pretendim bazuar edhe në faktin që nuk u mbështet në ndonjë dokumentacion provues.

- Lidhur me përlllogaritjet e shpenzimeve të arsimit të bashkëshortit, Komisioni vlerëson se ky pretendim duhet të merret në konsideratë për sa kohë subjekti provon me dokumentacion nga universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë, vlerat tarifore për secilin vit. Shkresa nga universiteti bazohet në tarifën e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave sipas udhëzimit nr. 13, datë 28.5.2007, i cili referon degën e studimit dhe universitetin përkatës, që në rastin e bashkëshortit të subjektit⁴⁷ kjo tarifë rezulton në shumën 80.000 lekë. Ky vlerësim i Komisionit merr çmuarje të tillë për shkak se gjendet edhe në harmoni me deklarin e kryer nga bashkëshorti i subjektit në DPV/2008, në rubrikën e detyrimeve ku ai deklaroi se: *“Totali i detyrimit të shlyer për studim 2005 – 2009 është 240.000 lekë dhe shuma e detyrimit financiar që ka mbetur 80.000 lekë”*. Në përputhje me këtë deklarin, bashkëshorti i subjektit në DPV/2009 deklaroi se ka paguar vlerën 80.000 lekë, pra aq sa ishte detyrimi i mbetur nga vitit 2008.

1.22.3 Lidhur me analizën financiare të vitit 2009, Komisioni, sikurse edhe në vitin 2008, nuk ka marrë në konsideratë pretendimin e subjektit që shpenzimet e mobilimit të shpërndahen për gjithë periudhën e deklarin. Ndërsa për sa i përket një udhëtimi në shtetin grek, ku sipas subjektit, bashkëshorti i saj nuk ka qenë asnjëherë në të dhe ky shpenzim duhet të jetë 0 (zero) në tabelën e sistemit *TIMS*, Komisioni vlerëson ta marrë në konsideratë pretendimin e subjektit, pasi nga njëra anë vërehet se informacioni nga Policia e Shtetit, nuk është i saktë pasi në të pasqyrohet vetëm data e hyrjes nga pika kufitare Kakavijë, linja e udhëimit me autobus dhe nuk pasqyrohen të dhëna për datën e daljes dhe pikën kufitare, dhe nga ana tjetër përfshirja ose jo e këtij shpenzimi (bileta e udhëimit) nuk ka impakt në analizën financiare.

1.22.4 Lidhur me analizën financiare të vitit 2013, sa përket i pretendimit të subjektit për përlllogaritje të shpenzimeve sipas çmimit të biletave, Komisioni çmoi se ky pretendim duhet të merret në konsideratë pasi i përgjigjet vlerës reale të paguar e dokumentuar nga subjekti dhe, për rrjedhojë, janë kryer ripërlllogaritjet përkatëse. Lidhur me pretendimin e ditëve të qëndrimit jashtë vendit, Komisioni e ka marrë në konsideratë këtë pretendim, pasi rezultoi se një pjesë e tyre i

⁴⁷ Ka studiuar në Universitetin e Vlorës, dega Drejtësi, sipas diplomës së depozituar nga subjekti në prapësime.

përkasin vitit 2014, kjo vërtetuar nga sistemi *TIMS*, ku subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e saj (bashkëshorti dhe djali) dalin jashtë vendit në vitin 2013 dhe hyjnë në Republikën e Shqipërisë në shkurt të vitit 2014. Si rezultat i këtij konstatimi ndryshojnë shpenzimet e qëndrimit jashtë vendit për vitet 2013 dhe 2014. Subjekti ka pretenduar që, meqenëse ditët e qëndrimit jashtë vendit për të dhe familjarët e saj kanë qenë të shumta, ato ditë ose periudha kohore e qëndrimit jashtë duhet të zbritet nga shpenzimet e jetesës pasi publikohet. Komisioni përlllogarit ditët e qëndrimit jashtë vendit për subjektin e rivlerësimit dhe familjarët e saj, nga ku rezultoi se për vitin 2013 kishin qëndruar jashtë vendit për 154 ditë dhe për vitin 2014 kishin qëndruar jashtë vendit 192 ditë. Këto ditë janë bërë zbritje nga shpenzimet jetike vjetore dhe janë përlllogaritur në shpenzimet e sistemit *TIMS*.

1.22.5 Komisioni, në vlerësimin tërësor të situatës financiare të subjektit për periudhën e analizuar 2006 – 2016, pas marrjes në konsideratë vetëm të disa pretendimeve të arsyeshme të dokumentuara nga subjekti pas ripërlllogaritjeve, konstaton se balanca negative nga 1.694.560 lekë rezulton në 1.059.821 lekë, pasqyruar në tabelën si vijon:

Tabela nr. 4

Nr	Përshkrimi	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
1	TË ARDHURA	819,036	3,289,681	601,580	904,004	1,106,828	1,339,121	1,366,837	1,194,625	1,558,900	2,985,866	1,992,411
	Të ardhura nga paga Subjekti	819,036	871,481	601,580	844,004	796,356	800,349	807,040	821,823	1,010,969	1,103,474	1,088,251
	Të ardhura nga paga Bashkëshorti	-	-	-	-	370,472	538,772	559,797	372,802	547,931	879,892	904,160
	Të ardhura nga ekzekutimi i vendimi gjyqësor nr.*** datë 21.11.2013 i Gj.RR.GJ VLORE	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1,002,500	-
	Kursime familjare bashkëshorti për këstin e parë të apartamentit	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Kredi NBG (20.000 euro) 28.09.2007	-	2,418,200	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Kontratë huaje 30.04.2009 nr.***	-	-	-	60,000	(60,000)	-	-	-	-	-	-
2	SHPENZIME	350,149	168,765	903,586	878,407	768,845	844,974	862,914	1,002,330	1,253,292	1,304,270	1,236,353
	Shpenzime jetese sipas ILDKPKI	109,557	136,620	387,090	409,860	409,860	409,860	405,685	363,571	544,269	672,828	705,276
	Shpenzime transporti (Vlore-Durrës-Vlorë)	154,000	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime kredia (principla+interes)	-	32,145	196,496	218,808	221,424	220,611	222,876	237,384	238,462	234,275	230,224
	Shpenzime mobilimi	-	-	240,000	160,000	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime TIMS	86,592	-	-	-	127,705	204,684	225,131	392,261	363,605	120,306	144,367
	Shpenzime extra kredia	-	-	-	9,739	9,856	9,819	9,222	9,114	9,107	8,810	8,657
	Shpenzime (blerje online)	-	-	-	-	-	-	-	-	97,849	178,052	57,829
	Shpenzime arsimimi bashkëshorti	-	-	80,000	80,000	-	-	-	-	-	-	-
	Shpenzime arsimimi djali	-	-	-	-	-	-	-	-	-	90,000	90,000
3	PASURI	(9,607)	3,624,186	254,544	23,323	16,025	(14,058)	391,334	140,740	(58,865)	879,091	67,265
	Pasuri e paluajtshme/e luajtshme											
	Ap.me sip.84 m2 akt marrëveshje 16.08.2007	-	3,627,300	307,956	-	-	-	-	-	-	-	-
	Automjet Daimler Chrysler kontratë nr.*** datë 18.05.2012 (***)	-	-	-	-	-	-	419,160	-	-	-	-
	Ndryshim Likuiditeti	(9,607)	(3,114)	(53,412)	23,323	16,025	(14,058)	(27,826)	140,740	(58,865)	879,091	67,265
	DIFERENCA (1-2-3)	478,494	-503,270	-556,550	2,274	321,958	508,205	112,589	51,555	364,473	802,505	688,794

Vlerësimi tërësor i kriterit të pasurisë

1.22.6 Trupi gjykues i Komisionit, në vlerësim të situatës së mësipërme, çmon se balanca negative në shumën 1.059.821 lekë, në masën 50% të saj është rrjedhojë e mospërfshirjes së kursimeve të familjarëve të të fejuarit të subjektit, si burim krijimi përpara martesës dhe bashkëjetesës së subjektit me personin e lidhur me të. Në këtë drejtim, trupi gjykues çmon se pavarësisht se këto të ardhura nuk janë sipas standardit të nenit D të Kushtetutës, dokumentacioni i depozituar nga subjekti dhe shpjegimet e dhëna prej saj vlerësohen të tilla se ato nuk cenojnë në nivel të mjaftueshëm⁴⁸ kriterin e pasurisë. Problematika e konstatuar në drejtim të pamjaftueshmërisë financiare të shpërndarë në dy vite në raport me rrethanat e tjera vlerësohet nga trupi gjykues se

⁴⁸ Shihni vendimet nr. *** dhe nr. *** të Kolegjit.

subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, kjo problematikë nuk mund të shërbejë për t’u kualifikuar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse ajo ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, i ka dërguar Komisionit raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës, deklasifikuar plotësisht me vendimin⁴⁹ e KDZH-së ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar *përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj.*

2. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

3. Në vijim, Komisioni i ka kërkuar DSIK-së përditësimin⁵⁰ e raportit, si dhe deklasifikimin e informacionit të përditësuar. Nga hetimi, pas përditësimit të raportit⁵¹, nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

4. Nga hetimi i kryer nga Komisioni nuk ka rezultuar që subjekti të ketë pasur ndonjë kontakt të papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Kësisoj, në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nga verifikimet e kryera: (i) nuk rezultoi se ka pasur apo të ketë aktualisht kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (ii) ka dorëzuar në kohë deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk ka bërë deklaram të pasakta, të paplota dhe nuk ka fshehur të dhëna apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

5. Raporti për analizimin e aftësive profesionale është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti ka përshkruar dhe analizuar dokumentet e vlerësimit profesional të subjektit Vjola Canaj, gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë:

⁴⁹ DSIK-ja deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 14.10.2022, të KDZH-së.

⁵⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 9.9.2022.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 29.3.2022.

- a) aftësitë profesionale;
- b) aftësitë organizative;
- c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Analiza e gjetjeve

Analiza e gjetjeve nga raporti i vlerësimit të aftësive profesionale, hartuar nga Grupi përkatës i Punës, i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; si dhe (iv) të dhënave nga burimet arkivore në KLGJ-së.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj identifikon normën ligjore të zbatueshme në funksion të zgjidhjes së çështjes gjyqësore, analizon normën penale në raport me rrethanat konkrete të mosmarrëveshjes dhe nxjerr konkluzione mbi çështjen nga zbatimi i saj.

Ajo ka njohuri të konsoliduara për procedurën e shqyrtimit të çështjeve penale. Merr përgjithësisht në analizë kryesisht kompetencën lëndore dhe tokësore, për shkak të gjykimit të çështjeve penale me të mitur (seksion i ngritur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë në zbatim të Dekretit nr. ***, datë 11.6.2007, të Presidentit). Gjyqtarja Vjola Canaj ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore⁵² dhe në pesë dosjet⁵³ e vëzhguara është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, si dhe analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjyqtarja Vjola Canaj kujdeset për përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes, si dhe për identifikimin e ligjit të zbatueshëm, duke identifikuar sipas rastit ligjin e posaçëm, por nuk identifikon praktikën unifikuese gjyqësore, Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, si pjesë e legjislacionit të brendshëm.

Subjekti i rivlerësimit ka njohuri për procedurën e shqyrtimit të çështjeve gjyqësore penale në funksion të zgjidhjes së çështjes. I kushton rëndësi kërkimeve procedurale në raport me rregullat procedurale dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi to.

Nga ana tjetër, në tri vendimet gjyqësore të paraqitura nga gjyqtarja përmbahen të dhëna se janë ankimuar në gjykatat më të larta dy çështje, të cilat janë lënë në fuqi, ndërsa ndër pesë dosjet

⁵² Dokumenti 1 – vendimi nr. ***, datë 6.10.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurve A. R e K. G; dokumenti 2 – vendimi nr. ***, datë 7.4.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurit M. B; dokumenti 3 – vendimi nr. ***, datë 13.2.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurve F. M, E. B M e F. K.

⁵³ (1) Çështja penale nr. *** regjistri themeltar, datë 2.10.2015 regjistrimi, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurit J. B, i akuzuar për veprat penale “kultivim i bimëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/1 i Kodit Penal dhe “mbajtje pa leje e armëve të gjuetisë”; (2) çështja penale nr.***, datë 29.9.2014 , që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurit L. P, i akuzuar për veprën penale “drejtim i automjetit në mënyrë të parregullt”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal; (3) çështja penale nr. ***, datë 27.11.2015, që i përket kërkuesit Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurve N. H, A. F e L. Xh, të akuzuar për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, kryer në bashkëpunim; (4) çështja penale nr. ***, datë 27.10.2014, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë kundër të pandehurit K. K, i akuzuar për veprën penale “vjedhje” mbetur në tentativë, parashikuara nga nenet 134/1 e 22 të Kodit Penal; (5) çështja penale nr. ***, datë 2.10.2014, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “vleftësimin e ligjshëm të arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’ të shtetasit T. F, i dyshuar për veprën penale ‘vrasjes me dashje’ e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 76 e 22 të Kodit Penal”.

gjqësore të përzgjedhura me short konstatohet se janë ankimuar 2 vendime, të cilat janë lënë në fuqi.

Duhet evidentuar gjithashtu fakti se veprimtaria e saj gjyqësore nuk ka qenë objekt i një numri të lartë ankesash. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 – 8 tetor 2016, për gjyqtaren Vjola Canaj janë paraqitur në Inspektoratin e KLD-së dy ankesa (në vitin 2014): një ankesë e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mungesë solemniteti në gjykim dhe ka rezultuar se nuk ka pasur shkelje nga ana e gjyqtares; një ankesë e vitit 2014, informacion i ardhur nga kryetari i gjykatës lidhur me vendimet e cenuara, është verifikuar dhe është vendosur evidentim për efekt vlerësimi profesional dhe etik për gjyqtaren.

b) Arsyetimi ligjor

Vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj, përgjithësisht, janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural penal. Pjesa hyrëse e vendimit paraqitet e plotë, duke treguar të dhëna mbi gjykatën, trupin gjykues, sekretaren gjyqësore, palët, akuzat dhe pretendimet përfundimtare të palëve. Në pjesën arsyetuese ajo orientohet drejt faktit të mosmarrëveshjes dhe pretendimeve të palëve. Përgjithësisht i analizon provat në funksion të përcaktimit të faktit penal, me përjashtim të dy rasteve. Tek analiza ligjore, në disa raste citon dispozitat e zbatueshme dhe i analizon ato, ndërsa në disa raste të tjera mjaftohet me referimin te dispozitat ligjore. Gjyqtarja, përgjithësisht, i kushton rëndësi analizës së rrezikshmërisë shoqërore të të pandehurit, shkallës së fajit dhe rrethanave lehtësuese në caktimin e masës së dënimit. Në dy raste, ky arsyetim nuk ka qenë i detajuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Gjyqtarja respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Dispozitivi i vendimit hartohet prej saj në mënyrë të plotë dhe përgjithësisht është rrjedhojë e pjesës arsyetuese të vendimit. Aty disponohet rregullisht mbi fajësinë e të pandehurit, llojet dhe masat e dënimit, si dhe mbi veprimet dytësore që lidhen me vuajtjen e dënimit, provat materiale dhe shpenzimet procedurale. Në të gjitha rastet është konstatuar se në dispozitivin e vendimit shprehet për shpenzimet procedurale dhe gjyqësore. Aty tregohet e drejta dhe afati i ankimit.

Nuk është identifikuar asnjë rast nga tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga gjykatat më të larta, për shkak të procesit të rregullt ligjor në aspektin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në 4 rastet ku vendimi është ankimuar, pas shqyrtimit gjyqësor nga gjykatat më të larta, ka rezultuar se vendimet nuk janë cenuar. Gjithashtu, në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se gjyqtarja arsyeton vendimet e ndërmjetme, të cilat paraqiten në tërësi me referenca ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Ajo ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës 339 çështje, se ka përfunduar 333 çështje dhe ka të mbartura 16 çështje.

Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna, është 98.2%.

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja Vjola Canaj ka qenë brenda afatit standard apo ligjor. Konkretisht, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 26 ditë, 1 muaj e 26 ditë, 2 muaj e 26 ditë, 1 muaj e 4 ditë, 15 ditë, 2 muaj e 26 ditë dhe 1 muaj e 15 ditë.

Në drejtim të kohëzgjatjes së gjykimit duhet evidentuar se nga 2 ankesat e paraqitura ndaj gjyqtares Vjola Canaj në Inspektoratin e ish-KLD-së, vetëm një ankesë (në vitin 2014) është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe mungesë solemniteti në gjykim dhe ka rezultuar se nuk ka pasur shkelje nga ana e gjyqtares. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja Vjola Canaj i ka arsyetuar vendimet gjyqësore në interval kohor: 2 ditë, 3 ditë, 4 ditë dhe 7 ditë.

Në analizë të të dhënave të mësipërme konstatohet se subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Në rastet e vëzhguara të tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore me short ka respektuar afatet standarde të gjykimit. Lidhur me kohën e arsyetimit të vendimeve rezulton se gjyqtarja i ka kushtuar vëmendje arsyetimit në kohë të vendimeve gjyqësore. Nga pesë dosjet e vëzhguara rezulton se vendimet janë arsyetuar brenda afatit ligjor 5 ditë dhe vetëm në 1 rast ky afat ka qenë 7 ditë.

Së fundmi, duke iu referuar të dhënave më sipër, konstatohet se gjyqtarja Vjola Canaj ka aftësi për të përballuar ngarkesën në punë.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Gjyqtarja Vjola Canaj ka marrë masat për vënien në lëvizje të çështjes menjëherë përmes vendimeve formale për caktimin e seancës gjyqësore. Konkretisht, është konstatuar se nga marrja e akteve të çështjes me short, ajo vepron duke respektuar afatin 10-ditor të përcaktuar nga neni 333 i Kodit të Procedurës Penale.

Gjyqtarja Vjola Canaj, përgjithësisht, respekton afatet në caktimin e seancave kur ligji ka caktuar afat për zhvillimin e tyre. Vetëm në një rast është konstatuar seanca e caktuar në tejkallim të afatit procedural 15-ditor të përcaktuar nga neni 342 i Kodit të Procedurës Penale për shkak të festave të fundvitit dhe mbartjeve të dosjeve.

Gjatë gjykimit gjyqtarja identifikon veprimet procedurale që duhen kryer dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme, të cilat janë të arsyetuara dhe në tërësi përmbajnë referenca ligjore. Zhvillon sipas ligjit procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesit gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, prezantimin e gjykatës, nevojën e asistimit të të pandehurit të mitur me praninë e prindërit dhe me caktimin kryesisht të mbrojtësit, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve deri në shpalljen e vendimit. Ndër pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se në asnjë rast çështja e gjykuar prej saj nuk është kthyer për rigjykim për shkelje të procedurave gjyqësore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore përgjithësisht janë të rregullta. Nga dokumentacioni në dosjen e vëzhguar konstatohet se janë përfshirë rregullisht kërkesa e prokurorit për gjykimin e çështjes së bashku me fashikullin penal dhe provat e tjera, fleta e shortit, vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, aktet e njoftimit të palëve, procesverbali gjyqësor, diskutimet përfundimtare, vendimi gjyqësor me shkrim kompjuterik dhe i zbardhur. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera që lidhen me përshkrimin e palëve, dokumenton kohën dhe vendin e gjykimit, objektin e akuzës penale, bazën e saj ligjore, si dhe të gjitha veprimet që kryhen në seancë gjyqësore konform kërkesave të neneve 345/1 dhe 346 të

Kodit të Procedurës Penale. Në një rast, procesverbali ka pasaktësi në pasqyrimin e emrit të gjyqtarës, ku në krye të tij është pasqyruar emri i një gjyqtareje tjetër. Nga ana tjetër, procesverbali është i nënshkruar rregullisht në çdo faqe, si dhe në fund nga sekretarja gjyqësore dhe gjyqtarja. Vendimet e ndërmjetme janë të arsyetuara dhe tregojnë referencën ligjore, duke respektuar nenin 112, pika 3 e Kodit të Procedurës Penale. Vendimi gjyqësor është hartuar si dorëshkrim me kompjuter dhe është nënshkruar në çdo faqe dhe në fund nga gjyqtarja dhe një kopje e zbardhur me kompjuter, e nënshkruar nga gjyqtarja dhe sekretarja gjyqësore. Renditja e akteve në dosjen gjyqësore lehtëson përdorimin e saj. Fashikulli gjyqësor është i inventarizuar nga sekretarja gjyqësore.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtarja Vjola Canaj ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 5.7.2002 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2006. Pas studimeve, në datën 6.11.2006, ajo është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, detyrë që kryen dhe aktualisht.

Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore për periudhën e rivlerësimit nuk rezulton që ndaj saj të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor apo të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore nuk është konstatuar gjykim i çështjeve tej afateve standard, nuk rezulton që ndonjë seancë gjyqësore të jetë shtyrë për mungesë të gjyqtarës, si dhe ka vetëm një rast të dorëzimit të vendimit të arsyetuar me vonesë (2 ditë) dhe kjo vonesë nuk ka sjellë pasoja për palën në lidhje me ushtrimin e të drejtës së ankimit, pasi vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga gjyqtarja Vjola Canaj dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të gjyqtarës Vjola Canaj. Në asnjë rast nuk është kërkuar përjashtimi i saj nga gjykimi i çështjes. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Vjola Canaj komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse. Në rastet kur iu drejtohet të tretëve me shkresa konstatohet se gjuha është e sjellshme dhe brenda etikës gjyqësore. Në të tria dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Vjola Canaj për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore,

si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nga 5 çështjet e verifikuara me short janë gjykuar nga gjyqtari i vetëm në 5 raste.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit Vjola Canaj, për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së parë, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Të dhënat e Shkollës së Magjistraturës tregojnë se gjatë periudhës së rivlerësimit ka qenë pjesëmarrëse në 7 trajnime vazhduese pranë kësaj shkolle. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtares në fushën civile, penale dhe të marrëdhënieve të punës.

Këto të dhëna tregojnë se subjekti ka marrë pjesë në 10 ditë (për një rast nuk është pasqyruar koha e pjesëmarrjes) të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, përgjithësisht nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me detyrën e gjyqtares së seksionit penal për gjykimin e të miturve, por me tema të tjera lidhur me trukimet në fushën sportive, mbrojtjen e të dhënave personale, shoqëritë tregtare, të drejtat e njeriut dhe marrëdhëniet e punës. Nuk ka të dhëna të dokumentuara që gjyqtarja Vjola Canaj të jetë angazhuar në aktivitete të tjera profesionale.

C/1. RIVLERËSIMI I AFTËSISË PROFESIONALE

i) Komisioni, lidhur me këtë kriter, është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të miratuar nga KLGJ-ja;
- kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

ii) Komisionit, në lidhje me analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit në tërësi, sikurse i ka rezultuar edhe Grupit të Punës në raportin e tij të vlerësimit, duket se nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me gjykimin e zhvilluar nga subjekti i rivlerësimit në të tria dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura me short. Duket se të gjitha vendimmarrjet e ankimuar janë lënë në fuqi. Komisioni ka konstatuar se në rastet e verifikuara të tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të përzgjedhura në mënyrë rastësore me short subjekti i rivlerësimit ka respektuar afatet standarde të gjykimit dhe vendimet janë arsyetuar brenda afateve ligjore, përjashtimisht një rast me dy ditë vonesë.

iii) Po ashtu rezulton se nuk konfirmohen propozime për masë disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit përgjatë kohës së ushtrimit të detyrës. Subjekti, në arsyetimin e vendimeve, përmend dhe analizon rast pas rasti norma të Kushtetutës, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile, KEDNJ-së.

C/2. Mbi denoncimet e depozituara pranë Komisionit për subjektin e rivlerësimit

Pranë Komisionit janë regjistruar 5 denoncime për subjektin e rivlerësimit, të administruara dhe vlerësuara në përputhje me nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, të cilat paraqiten të trajtuara si vijon:

1. Denoncim⁵⁴ i shtetasës V.XH

Shtetasja V.XH denoncon subjektin e rivlerësimit për çështjen penale me objekt “ankim kundër vendimit nr. *****, datë 27.7.2017” të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, për të cilën pretendon

⁵⁴ Denoncim me kërkesë nr. *** prot., datë 20.2.2018.

se zvarritet me dashje nga ana e gjyqtarëve në bashkëpunim me prokurorët, në mënyrë të dukshme korruptive. Denoncuesja pretendon se subjekti i rivlerësimit ka dhënë dënim maksimal për një të pafajshëm, në rastin konkret për djalin e saj I.XH. Në këtë çështje penale, djali I.XH dhe shoku i tij E.L, në cilësinë e të pandehurve, janë gjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me akuzën për kryerjen e veprave penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike kryer në bashkëpunim” dhe “mbajtje, prodhim dhe transportim i substancave kimike” dhe është dënuar 9 vjet, referuar neneve 283/2 dhe 285 të Kodit Penal.

Denoncuesja kërkon ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë me pretendimin se ky vendim është marrë në kundërshtim me ligjin dhe është plotësisht i pabazuar në prova dhe, si rrjedhojë, kërkon pushimin e çështjes dhe shpalljen e të pandehurit I.XH të pafajshëm. Komisioni, për nevoja të hetimit administrativ, i ka kërkuar⁵⁵ Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kopje e dosjes gjyqësore, e cila⁵⁶ ka kthyer përgjigje se dosja me nr. *** vendimi, datë 27.7.2017, ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë sipas shkresës nr. *** regjistri, datë 21.6.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Komisioni, gjatë shqyrtimit të kësaj dosjeje penale, ka konstatuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 27.7.2017, e ka dënuar shtetasin I.XH me 9 vjet burg duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotikeve”, referuar nenit 283/2 të Kodit Penal me relator të çështjes gjyqtarin S.H. Më pas, ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me trup tjetër gjykimi (me përbërje subjektin e rivlerësimit), i cili me vendimin nr. ***, datë 27.7.2017, ka vendosur dënimin e shtetasit I.XH me 8 vjet burgim, duke e deklaruar atë fajtor për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotikeve në bashkëpunim”, referuar nenit 283/2 të Kodit Penal.

Ky vendim është ankimuar përsëri dhe nga hetimi administrativ i Komisionit është konstatuar se Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur me vendim⁵⁷ lënien në fuqi pjesërisht të vendimit nr. ***, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe ka ndryshuar pjesën tjetër të vendimit në këtë mënyrë:

- Ka deklaruar të pafajshëm të pandehurin I.XH për kryerjen e veprës penale “prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, referuar nenit 283/2 të Kodit Penal.
- Shuarjen e masës së sigurimit “arrest me burg” për të pandehurin I.XH për efekt të këtij procedimi penal.

Për sa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁵⁸ informon se çështja penale ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, pasi është bërë rekurs nga Prokuroria e Rrethit Vlorë.

Komisioni, nga verifikimi i akteve në dosje në raport me pretendimet e denoncuesit, konstatoi se ato lidhen me themelin e çështjes, për zgjidhjen e së cilës ka kompetencë Gjykata më e Lartë.

Komisioni, lidhur me çështjen më sipër, pas përfundimit të hetimit administrativ i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me statusin ligjor aktual të çështjes gjyqësore, si dhe të depozitojë dokumentacionin justifikues.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

⁵⁵ Nëpërmjet shkresës nr. ***prot., datë 17.5.2022.

⁵⁶ Me shkresë dërguar kopje të dosjes nga gjykata e shkallës së parë, me nr. *** prot., datë 31.5.2022.

⁵⁷ Vendim nr. ***, datë 7.3.2018, i Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2022, dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në prapësimet e dërguara në lidhje me denoncimin e shtetasës V.XH, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se vendimi i dënimit është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 7.3.2018, e cila ka bërë një vlerësim të ndryshëm të provave të shqyrtuara gjatë gjykimit në shkallë të parë, duke vlerësuar si kontradiktore, për pasojë të pabesueshme deklaratimet e dëshmitarëve, të cilët kanë qenë punonjës policie. Gjykata e Apelit nuk ka konstatuar shkelje procedurale të kryera nga gjykata e shkallës së parë me pasojë cenimin e të drejtave të personave në gjykim.

Subjekti ka shpjeguar për statusin juridik se dosja penale ndodhet në Gjykatën e Lartë, fakt të cilin e ka vërtetuar duke iu referuar informacionit të marrë nga sistemi elektronik i Gjykatës së Lartë, si dhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Bashkëlidhur shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar⁵⁹ edhe një kopje të njëzuar të vendimit nr. ***, datë 27.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, shoqëruar me vendimin nr. ***, datë 7.3.2018, të po kësaj gjykate.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti dhe dokumentacionit provues të depozituar, paraprakisht ka konstatuar se pretendimet e denoncuesit lidhen me themelin e çështjes.

Nga analizimi i vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, depozituar nga subjekti, trupi gjykues nuk konstaton shkelje procedurale me pasojë cenimin e të drejtave të personave në gjykim. Ajo që identifikohet në këtë vendim është ekzistenca e një vlerësimi të ndryshëm të provave të shqyrtuara gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Trupi gjykues, duke konstatuar për sa më sipër, në konsideratë të faktit se vlerësimi i aftësive profesionale kryhet mbi aspektin etik dhe procedural për të evidentuar shkelje të mundshme të të drejtave të palëve, pa iu nënshtruar analizës faktiko-ligjore, ku vlerësimet e provave dhe vendimmarrjet lidhen me themelin e çështjes, çmon se nuk evidentohen problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

2. Denoncim⁶⁰ i shtetasit G.T

Ky shtetas ankohet në tërësi për subjekte të tjera (gjyqtar dhe prokurorë) lidhur me vendimmarrje gjyqësore të paligjshme (duke cituar disa vendime gjyqësore) dhe abuzim me detyrën në gjykimin e çështjeve dhe për vendimmarrje në kundërshtim me ligjin. Në këtë tërësi denoncimesh, ndër të tjera, rezulton denoncimi për subjektin e rivlerësimit, ku pretendon se në gjykimin e çështjes penale me nr. ***, me akuzë “vjedhje duke shpërdorur detyrën”, referuar nenit 135 të Kodit Penal subjekti ka dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin. Në këtë vendim shtetasi G.T është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “vjedhje duke shpërdoruar detyrën” dhe është dënuar me 5 vjet heqje lirie.

Në vijim të hetimit për këtë denoncim, Komisioni kërkoi kopje të dosjeve gjyqësore⁶¹ nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶², e cila ka përcjellë kopje të tyre ku konstatohet se në të dyja kërkesat, konkretisht: (a) kërkesës me nr. *** vendimi, datë 9.10.2017, me objekt përjashtimin e subjektit të rivlerësimit; dhe (b) kërkesës me nr. *** vendim, datë 15.11.2017, me të njëjtin objekt për përjashtim e saj nga gjykimi i çështjes penale nr. *** akti, datë 12.7.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, kjo e fundit në të dyja rastet nuk i ka marrë parasysh kërkesat e tij (pretenduesit)

⁵⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022.

⁶⁰ Denoncimi me shkresën nr. *** prot., datë 20.3.2018.

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.6.2022, e Komisionit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 15.6.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

për përjashtimin nga gjykimi të subjektit. Gjykata ka dalë në konkluzion me arsyetimin se nuk ka asnjë rast pajtueshmërie apo të jetë në kushtet ligjore kur subjekti duhet të japë dorëheqjen, pasi nga kërkuesi G.T nuk provohet asnjë nga shkaqet ligjore të parashikuara në nenet 15,16 dhe 17, të Kodit të Procedurës Penale.

Komisioni, gjatë hetimit, konstatoi se nuk identifikohen fakte apo rrethana që mund të ndikojnë në rivlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

3. Denoncim⁶³ i shtetas L.B

Në denoncimin e saj kjo shtetase pretendon se subjekti ka ndërmarrë një vendim jo të drejtë në lidhje me vendimin nr. ***, datë 5.2.2019, ku ka vendosur pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018. Kjo çështje ka për objekt aksidentin, ku fëmija 6-vjeçar i denoncueses është përplasur me pasojë vdekjen nga drejtuesja e automjetit, shtetasja M.M.

Në lidhje me këtë çështje, konkretisht, denoncuesja pretendon se:

- Gjyqtarja Vjola Canaj në vendimmarrje nuk ka marrë parasysh procesverbalin e vendngjarjes datë 15.8.2018 dhe nga eksperti A. Z. është konstatuar se shpejtësia e automjetit ishte 56 km/orë dhe këtë gjë e vërtetojnë edhe pamjet filmike.
- Subjekti nuk ka marrë parasysh provat filmike që kanë depozituar familjarët.
- Gjyqtarja ka zhvilluar seancën gjyqësore pa sistem audio dhe nga ana e gjykatës është kthyer përgjigje e moszhvillimit të seancës gjyqësore me sistem audio.
- Për këtë fakt ka investiguar edhe emisioni “****”, RTV “****”, datë 22.4.2019.

Komisioni, në lidhje me këtë denoncim dhe për nevoja të hetimit administrativ, ka kërkuar⁶⁴ kopje të dosjes gjyqësore. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁵ ka informuar se vendimi nr. ***, datë 5.2.2019, i kësaj gjykate ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë sipas shkresës nr. *** prot., datë 16.12.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë. Në vijim të hetimit, Gjykata e Lartë⁶⁶ ka përcjellë pranë Komisionit kopje të dosjes gjyqësore.

Nga hetimi i akteve të ndodhura në dosje rezultoi se seancat gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës penale me nr. ***, datë 5.12.2018, me kërkues Prokuroria Vlorë janë bërë pa audio, fakt i cili është evidentuar edhe në procesverbalin e ndodhur në dosje.

Subjekti i rivlerësimit, në vendimmarrje, u është referuar fakteve si vijon:

- Aktekspertimit auto-teknik të datës 12.8.2018, i plotësuar me aktin datë 14.8.2018. Sipas arsyetimit të subjektit, vërehet se për shkak të pretendimeve nga përfaqësuesi i trashëgimtarëve, për aktet e para të aktekspertimeve është kryer riekspertimi auto-teknik, me përbërje me tre ekspertë në datën 8.11.2018.
- Pamje filmike të kamerave të biznesit në afërsi të vendit të ngjarjes, të cilat janë marrë në cilësinë e provës materiale nga policia gjyqësore.

Në pjesën arsyetuese të vendimit nr. ***, datë 5.2.2019, subjekti arsyeton mbi provat dhe specififikisht aktekspertimet auto-teknike, ku përjashtohet përgjegjësia e shtetases së kallëzuar,

⁶³ Denoncim nr. *** prot., datë 15.5.2019.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 17.5.2022, dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 24.5.2022.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 15.6.2022.

duke vendosur “Pushimin e çështjes penale nr. ***, të vitit 2018, i regjistruar për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, referuar nenit 290/3 të Kodit Penal.

Komisioni nga hetimi konstatoi se vendimi nr. ***, datë 5.2.2019, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 19.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin si një vendim i drejtë i bazuar në ligj dhe në prova.

Vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë është ankimuar më pas në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁶⁷ ka shpjeguar se dosja që i përket vendimit nr. ***, datë 5.2.2019, të kësaj gjykate ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, sipas shkresës nr. *** prot., datë 16.12.2020, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Nga verifikimi i akteve të administruara⁶⁸, tri aktekspertimet auto-teknike (aktekspertimi auto-teknik i datës 12.8.2018, i plotësuar me aktin datë 14.8.2018, si dhe aktin për riekspertim auto-teknik në datën 8.11.2018), Komisioni konstatoi se referuar konkluzioneve të aktekspertimeve auto-teknike duket se përjashtohet nga përgjegjësia shtetasja e kallëzuar M.M për veprën penale “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, referuar nenit 290/3 të Kodit Penal. Po ashtu, vërehet se në të tria aktekspertimet auto-teknike rezulton si faktor determinant shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e këmbësorit.

Komisioni⁶⁹, pas përfundimit të hetimit administrativ, i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime lidhur me pretendimet e denoncueses, si dhe statusin ligjor në të cilin ndodhet kjo çështje.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e dërguara për denoncimin e shtetasës L.B, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se lidhur me gjykimin e çështjes gjyqësore pa sistemin audio, objekt shqyrtimi ka qenë kërkesa për pushimin e procedimit penal, e cila bazuar në nenin 329/b, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale zhvillohet në seancë me dyer të mbyllura në prani të palëve. Ky fakt është pasqyruar edhe në pjesën hyrëse të vendimit.

Subjekti ka shpjeguar se gjykimi me dyer të mbyllura presupozon marrjen e masave për mospublikimin e akteve dhe gjykimi me sistemin audio nuk garanton mospublikimin e akteve dhe cenon gjykimin me dyer të mbyllura. Për këtë shkak, seanca është zhvilluar pa sistemin audio, me qëllim garantimin e zhvillimit të procesit “me dyer të mbyllura” për mospublikimin e akteve të hetimit paraprak.

Për sa i përket pretendimeve të ankueses për mosvlerësim të provave, subjekti ka parashtruar se nga ana e saj janë vlerësuar provat që janë paraqitur nga prokuroria dhe vendimi është bazuar në të dhënat e provave shkencore si tre aktekspertimet auto-teknike, të kryera nga ekspertë të ndryshëm, të cilët kanë pasur në dispozicion për kryerjen e tyre të gjitha aktet e hetimit paraprak, këqyrjen e vendit të ngjarjes, raportet e policisë, deklaratimet e palëve, filmimet e marra si provë materiale në rrugë procedurale nga policia gjyqësore, bazuar edhe në deklaratimet e palëve të dëmtuara. Të tria aktekspertimet kanë pasur konkluzion kategorik në lidhje me veprimet e palëve të përfshira në aksident.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁶⁸ Kërkuar në datën 21.10.2022 nëpërmjet postës elektronike.

⁶⁹ Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të shpjegimeve subjekti ka sqaruar se statusi ligjor i çështjes gjyqësore, referuar faqes elektronike të Gjykatës së Lartë, vazhdon të jetë i pashqyrtuar në këtë gjykatë, fakt i cili është konfirmuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁰.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, pas analizimit të kësaj çështjeje, i vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me gjykimin e çështjes gjyqësore pa sistemin audio, pasi nga verifikimi i akteve në dosje konstatohet se: (i) gjykimi pa sistemin audio është kryer pas kërkesës së prokurorit për pushimin e çështjes dhe gjykata është bazuar në nenin 329/b, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon se *“Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve”*; (ii) në procesverbalin e seancës gjyqësore, datë 14.1.2019, përshkruhet se për shkak të llojit të çështjes dhe duke qenë se ka karakter sekret, gjykata çmon se ky gjykim duhet të zhvillohet jo nëpërmjet sistemit FTR, audio, të cilin subjekti e ka pasqyruar edhe në pjesën hyrëse të vendimit.

- Lidhur me pretendimin e denoncueses për mosmarrjen në konsideratë të provave, trupi gjykues, pavarësisht se në këtë çështje ka vërejtur se: (a) vendimi i disponuar nga gjykata është rrjedhojë e çmuarjes së provave shkencore/aktekspertimet autoteknike të kryera nga ekspertë të ndryshëm, aktet e këqyrjes së vendit të ngjarjes, raportet e policisë, deklaratimet e palëve, filmimet e marra si provë materiale, deklaratimet e palëve të dëmtuara, etj.; apo se (b) ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit⁷¹ – konstaton se ky pretendim i denoncueses është lidhur tërësisht me themelin e çështjes, për të cilin Komisioni nuk ka kompetencë. Në përfundim, trupi gjykues, në të tilla kushte, nuk ka konstatuar problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit.

4. Denoncim⁷² i shtetasit XH.H

Në denoncimin e tij ky shtetas i referohet ngjarjes së ndodhur në vitin 1998, me akuzën e veprës penale “vrasje me paramendim” në ngarkim të të pandehurit G.S, i cili akuzohet për vrasjen e dy shtetasve (vëllezër) B dhe E.H.

Denoncuesi ankohet se subjekti ka dhënë një vendim gjyqësor jo të drejtë ndaj çështjes penale në ngarkim të të pandehurit G.S, i proceduar penalisht për veprën penale “vrasje me paramendim dhe mbajtje pa leje dhe prodhim i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”, parashikuar nga nenet 78 dhe 278/1 të Kodit Penal.

Subjekti, me vendimin nr. ***, datë 28.3.2022, ka ndryshuar masën e sigurimit për të pandehurin G.S nga “arrest me burg”, e kërkuar nga Prokuroria e Rrethit Vlorë, në masën e sigurimit personal “arrest në shtëpi” (referuar nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale). Denoncuesi parashtron faktin se subjekti i rivlerësimit në vendimin e cituar më sipër ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “arrest në burg” me “arrest në shtëpi”, pa pasur asnjë rrethanë që ta justifikojë caktimin ndaj një të akuzuari për vrasje të dyfishtë.

Komisioni, për nevoja të hetimit administrativ, ka kërkuar⁷³ kopje të dosjes gjyqësore, për të cilën Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁷⁴ ka kthyer përgjigje se dosja që përmban vendimin me nr. ***,

⁷⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2022.

⁷¹ Me vendimin nr. ***, datë 19.3.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin si një vendim i drejtë i bazuar në ligj dhe në prova. Për këtë vendim është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila referuar edhe shpjegimeve të subjektit vazhdon të jetë e pashqyrtuar në këtë gjykatë, fakt që konfirmohet edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë me shkresën nr. *** prot., datë 10.11.2022.

⁷² Denoncim nr. *** prot., datë 6.4.2022.

⁷³ Shkresë nr. *** prot., 30.5.2022, dërguar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁷⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 31.5.2022, e përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

datë 28.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Vlorë në bazë të ankimit të paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Vlorë.

Për këtë arsye, Komisioni⁷⁵ i ka kërkuar Gjykatës së Apelit Vlorë kopje të dosjes gjyqësore me nr. ***, datë 28.3.2022, me objekt “verifikimin e masës së arrestit me burg” për shtetasin G.S dhe dosjen penale me nr. ***, vendimi “masë sigurimi”, që i përket shtetasit G.S. Gjykata e Apelit Vlorë⁷⁶ ka përcjellë pranë Komisionit kopje të dosjeve penale, ku nga administrimi i akteve në dosje u konstatua se Prokuroria e Rrethit Vlorë ka ankimuar këtë vendim në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila në ankesë ka parashtruar kërkesat si vijon:

- a) ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 28.3.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë;
- b) pranimin e kërkesës së prokurorisë për lënien në fuqi dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin G.S.

Më tej, Komisioni, nga verifikimi i akteve të fashikullit gjyqësor dhe arsyetimit të subjektit në vendimin e marrë, ka konstatuar⁷⁷ se subjekti arsyeton faktet e tilla në raport me kriteret ligjore të neneve 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale si vijon:

- Duhet të vijohet me masën e caktuar “arrest me burg”, pasi plotësohen kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit të parashikuara në nenet 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale.
- Gjatë gjykimit nuk rezultoi të kishte ndonjë shkak padënueshmërie të shuarjes së veprës penale.
- Për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën ai është proceduar referuar nenit 228, pika 3, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale.
- Referuar tërësisë së akteve të administruara në fashikullin penal të këtij vendimi, gjykata ka çmuar se ndaj personit nën hetim G.S duhet të vijojë masa e sigurimit “arrest me burg”, referuar nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale.

Për sa është parashtruar më lart, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit edhe pse gjatë gjithë pjesës arsyetuese të vendimit arsyeton kriteret ligjore lidhur me masën e sigurimit “arrest me burg”, referuar nenit 238 të Kodit të Procedurës Penale në fund të pjesës arsyetuese argumenton se masa më e përshtatshme për të arrestuarin G.S është ajo e arrestit në burg, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, ndërsa në dispozitiv të vendimit ka vendosur ndryshe: “Shuarjen e masës së sigurimit ‘arrest me burg’ dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në shtëpi’ ndaj shtetasit G.S me detyrimin që të mos largohet nga banesa e tij”.

Në përfundim të hetimit Komisioni, nga analizimi i akteve në dosje, fakteve të dala, si dhe arsyetimit të vendimit në raport me dispozitat ligjore⁷⁸ të ligjit nr. 96/2016, ka konstatuar se duket se:

⁷⁵ Shkresë nr.*** prot., datë 8.6.2022, e Komisionit drejtuar Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁷⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 17.6.2022, e Gjykatës së Apelit Vlorë.

⁷⁷ Komisioni, nga analizimi i vendimeve gjyqësore⁷⁷ dhe akteve të gjendura në dosje ka konstatuar se subjekti në pjesën arsyetuese të vendimit nr. ***, datë 28.3.2022, nuk përlligjet me pjesën e dispozitivit të vendimit.

⁷⁸ Ligji i aplikueshëm: sipas dispozitave të nenit 42, pika 1 e ligjit nr. 84/2016: “Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë, si dhe të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët vlerësohen bazuar në burimet e parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve”.

Pika 2 e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton që: “Aspekti i njohurive ligjore vlerësohet duke u bazuar në aftësinë e gjyqtarit për të marrë vendime gjyqësore, duke u bazuar në tregues të tillë si aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin, për të identifikuar konfliktin e normave, për të përdorur parimet e përgjithshme të teorisë së drejtës dhe aftësinë për të analizuar jurisprudencën”.

- Aplikimi i nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale, duke ndryshuar masën e sigurimit, nuk përputhet me kriteret ligjore të kësaj dispozite, si dhe nuk u përgjigjet rrethanave dhe provave të kësaj çështjeje.

- Nuk rezulton arsyetimi i plotë, analitik dhe logjik në vendim lidhur me aplikimin e nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale.

- Duket se sipas fakteve provuese dhe rrethanave të kësaj çështjeje gjyqësore penale duhej të ishte aplikuar neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, sikurse është e arsyetuar në vendim nga subjekti.

Komisioni⁷⁹ i kërkoi subjektit të japë shpjegime në lidhje me konstatimet e Komisionit, duke sqaruar edhe statusin në të cilin ndodhet kjo çështje gjyqësore, duke depozituar dokument justifikues, vendimin ose vërtetimin e shkallës më të lartë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në prapësimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit, në lidhje me denoncimin e shtetasit X.H.H, ka shpjeguar se: (i) masa e sigurimit “arrest në shtëpi” është vlerësuar prej saj si masa më e përshtatshme, duke pasur parasysh që i dyshuari nuk mund të ndikojë në marrjen dhe vërtetësinë e provave, duke qenë se nga koha e kryerjes së ngjarjes deri në shqyrtimin e kërkesës ka kaluar kohë mjaft e gjatë, më shumë se 20 vjet; (ii) pavarësisht disa gabimeve materiale, të cilat ndodhen në rreshtin e fundit të pjesës arsyetuese, në vendim është arsyetuar se ka qenë i nevojshëm caktimi i një mase sigurimi personal me karakter shtrëngues, bazuar në nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, të cilët parashikojnë kushtet dhe kriteret për caktimin e të gjitha masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues; (iii) në lidhje me llojin e masës së sigurimit, në paragrafin e dytë të faqes së fundit të vendimit, subjekti pretendon se ka arsyetuar që masa e kërkuar nga prokuroria “arrest në burg” nuk është e përshtatshme, por është vlerësuar si më e përshtatshme referuar gjendjes së akteve në dosjen hetimore masa e sigurimit “arrest në shtëpi”; (iv) vendimi i Gjykatës së Apelit Vlorë ka ndryshuar vendimin e subjektit të rivlerësimit, por nuk rezulton që vendimi të jetë konstatuar i paarsyetuar apo kontradiktor. Kjo gjykatë ka vlerësuar ndryshe aktet e ndodhura në dosjen hetimore dhe vendimi i saj mbështetet mbi vlerësim të ndryshëm të provave; (v) kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë nuk është ushtruar rekurs nga palët dhe dosja aktualisht ndodhet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vlerësimi i Komisionit

Trupi gjykues, për sa më sipër, vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse, si dhe nuk i përgjigjen situatës faktiko-juridike, të cilat identifikojnë mangësi profesionale si më poshtë arsyetohet:

Nga analizimi i akteve në dosje, Komisioni ka konstatuar faktet se: (a) nuk ka rezultuar ndonjë shkak padënueshmërie e shuarjes së veprës penale; (b) për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit, gjykata ka çmuar se i pandehuri ka rrezik që të kryejë krime të rënda

Pika 3 e nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” përcakton që: “Aspekti i arsyetimit ligjor të gjyqtarëve në marrjen e vendimeve vlerësohet duke u bazuar në tregues të tillë si qartësia dhe kuptueshmëria e vendimit, struktura e qëndrueshme dhe e mirorganizuar e vendimit, si dhe cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik”.

⁷⁹ Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

ose të të njëjtit lloj me atë për të cilën është proceduar referuar nenit 228, pika 3, germa “c” e Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues në këtë çështje vlerëson se aplikimi i nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale nga ana e subjektit, duke ndryshuar masën e sigurimit personal, nuk përputhet me kriteret ligjore të kësaj dispozite, si dhe nuk u përgjigjet rrethanave dhe provave të kësaj çështjeje, duke vlerësuar kështu se subjekti shfaq mangësi profesionale në kundërshtim me pikën 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Po në këtë çështje, trupi gjykues, sikurse ka konstatuar edhe përgjatë hetimit, çmoi se subjekti i rivlerësimit shfaq mangësi në pasqyrimin e analizës faktiko-juridike dhe argumentit logjik, pasi rezulton mospërputhje e pjesës arsyetuese të vendimit, me dispozitivin e tij ku disponohet ndryshe. Sipas Komisionit, në këtë rast identifikohen mangësi profesionale, sa i takon arsyetimit të plotë, analitik dhe logjik në vendim, lidhur me aplikimin e nenit 237 të Kodit të Procedurës Penale, duke e gjetur atë jo në përputhje me parashikimin ligjor, sipas pikës 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

5. Denoncim⁸⁰ i shtetas S.M

Shtetasit S dhe A.M kanë denoncuar subjektin e rivlerësimit për shpërdorim detyre duke dhënë vendime të padrejta ndaj pronarëve të ligjshëm në të gjitha gjykimet e çështjeve të tyre, ku kjo gjyqtare ka ndërmarrë vendime gjyqësore kundër pronarëve të ligjshëm.

Komisioni, për nevoja të hetimit për këtë denoncim⁸¹, ka kërkuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë kopje të dosjeve gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit që lidhen me këtë denoncim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë⁸² ka përcjellë pranë Komisionit kopje të dosjeve gjyqësore, ku nga aktet e administruara është konstatuar se për vendimin nr. ***, datë 26.10.2018, me palë ankuese S.M (H) dhe me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Vlorë, subjekti ka vendosur mospranimin e ankimit me objekt kundërshtimin e vendimit datë 26.9.2018, për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018.

Komisioni konstatoi se subjekti ka vendosur mospranimin e ankimit të denoncuesit, duke iu referuar nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale me arsyetimin se: (a) ankuesi nuk është paraqitur në seancë dhe nuk ka parashtruar dhe provuar ndonjë shkak të arsyeshëm për mosparaqitje; (b) prokuroria nuk ka paraqitur prova në mbështetje të pretendimeve të saj, por ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal ndaj dosjes penale me akuzën kallëzimin penal nr. ***, viti 2018; (c) ankuesi ka paraqitur ankimin objekt gjykimi pa aktet e dosjes hetimore që ajo kundërshton.

Sa më sipër, duket se ankimi i denoncuesve lidhet me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit (mospranimin e ankimit të ankueses S.M me objekt “mosfillim të procedimit penal”) dhe, konkretisht, duket se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë me interpretimin e provave dhe ligjit të zbatueshëm nga gjyqtarja, pretendime që mund të jenë objekt ankimi në gjykatën më të lartë – e drejtë e cila i është bërë me dije denoncuesve nga gjyqtarja në vendimin përkatës. Komisioni⁸³ është vënë në dijeni nga gjykata se vendimi nr. ***, datë 26.10.2018, ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

⁸⁰ Denoncim i protokolluar pranë Komisionit me nr. ***prot., datë 31.5.2022.

⁸¹ Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2022, e Komisionit drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁸² Shkresë nr. *** prot., datë 28.9.2022, e dërguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁸³ Shkresë nr. *** prot., datë 15.9.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dërguar Komisionit.

Nisur nga sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se pretendimet e denoncuesit kanë të bëjnë kryesisht me themelin e çështjes dhe vendimmarrjen. Në të tilla kushte, duket se nuk u konstatuan problematika që mund të ndikojnë në vlerësimin profesional apo etik të subjektit.

Gjetje të tjera: Komisioni, për shkak të një informacioni mediatik⁸⁴ administroi dosjen që i përket çështjes penale me objekt “vleftësim ndalimi dhe caktimin e masës së sigurimit personal”, gjykuar nga subjekti i rivlerësimit.

Rrethanat e çështjes

i. Emisioni investigativ *** ka denoncuar rastin ku shtetasi L.R akuzohet për veprën penale “ngacmim seksual”, referuar nenit 108/a/2 të Kodit Penal. Referuar materialit kallëzues rezulton se në datën 27.1.2019 është paraqitur pranë Komisarariatit të Policisë Fier shtetasja e mitur L.R me banim në fshatin ***, Njësia Administrative Roskovec në prezencë të nënës së saj dhe psikologut për të bërë kallëzim penal ndaj shtetasit L.R, me akuzën “ngacmim seksual”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, në vendimin nr. ***, datë 30.1.2019, ka vendosur: (a) vleftësimin e ligjshëm të ndalimit të shtetasit L.R, si i dyshuar për veprën penale “ngacmim seksual”, parashikuar nga neni 108/a/2 i Kodit Penal; (b) caktimin e masës së sigurimit personal “arrest me burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

ii. Komisioni, në vijim të hetimit, ka kërkuar⁸⁵ kopje të akteve që i përkasin dosjes penale nr. ***, datë 19.4.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Referuar këtij vendimi ka rezultuar se shtetasi i dënuar me masën e sigurimit personal “arrest me burg” ka kërkuar nëpërmjet avokatit të tij zëvendësimin e masës së sigurimit, referuar nenit 260 të Kodit të Procedurës Penale.

iii. Gjykata mori në shqyrtim këtë kërkesë duke vendosur “zëvendësimin e masës së sigurimit ‘arrest me burg’”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale, me masën e sigurimit “arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale.

iv. Komisioni, nga administrimi i akteve në dosje, konstatoi se subjekti i rivlerësimit në këtë vendimmarrje është bazuar në rrethanat e reja të dala dhe vlerësimin e provave si: (a) kriteri shëndetësor, referuar kartelës klinike mjekësore në emër të pacientit L.R që gjendet në dosje; (b) deklaratimet e familjarëve që janë pjesë e dosjes se marrëdhënia midis viktimës dhe të dyshuarit është një lidhje gjinore, se marrëdhëniet janë normalizuar, karakteristikat nga komuniteti janë të rregullta dhe natyra e veprimeve të autorit nuk janë në atë masë për një vepër penale të konsumuar; (c) nga aktekspertimi mjeko-ligjor ka rezultuar se nuk ka deflorim, fakt ky që evidentohet edhe në parashkrimin e prokurorit mbi bazën e të cilit është bazuar edhe vendimmarrja nga subjekti i rivlerësimit për zëvendësimin e masës së sigurimit personal.

Për sa është paraqitur më lart, Komisioni⁸⁶ ka kërkuar nga subjekti të japë shpjegime dhe argumente bindëse në lidhje me ndryshimin e masës së sigurimit personal ndaj shtetasit L.R.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e saj në lidhje me këtë denoncim, ka shpjeguar se në dhënien e këtij vendimi gjyqësor është bazuar në nenin 260 të Kodit të Procedurës Penale në rrethanat e reja të dala gjatë hetimit si: (i) kriteri shëndetësor referuar kartelës klinike mjekësore në emër të

⁸⁴ https://***

⁸⁵ Me shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2022, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

⁸⁶ Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

pacientit L.R; (ii) deklarinimet e familjarëve, të dhëna gjatë hetimit paraprak; (iii) konkluzionet e aktekspertimit mjeko-ligjor.

Gjithashtu, subjekti është referuar në dhënien e vendimit gjyqësor edhe te qëndrimi i organit të akuzës në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit, i cili në seancë është shprehur për pranimin e saj. Më tej, ka shpjeguar se bazuar në nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata nuk mund të caktojë një masë sigurimi më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokuroria. Pavarësisht se kërkesa ka qenë paraqitur nga i hetuari, qëndrimi pranues i prokurorisë në lidhje me kërkesën, vë gjykatën para detyrimit të mosrëndimit të pozitës së personit nën hetim, në kushtet ku është prokuroria ajo që disponon në lidhje me nevojat e sigurimit gjatë hetimit paraprak. Vendimi gjyqësor i dhënë nga subjekti i rivlerësimit nuk është ankimuar nga palët dhe është i formës së prerë.

Vlerësimi i çështjes nga Komisioni

Komisioni, në lidhje me këtë çështje, çmon se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe rrethanave të reja të dala gjatë hetimit dhe, për rrjedhojë, ato lidhen me themelin e çështjes dhe, për këtë shkak, Komisioni nuk ka kompetencë. Në këtë drejtim, po ashtu është konstatuar se palët nuk e kanë ankimuar këtë vendim, duke marrë formë të prerë.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kriteret e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke pasur në konsideratë: nenin E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, i cili përcakton se: *“Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”*; nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit *vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues*; vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: *“...në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht ‘të pasakta’ nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”* (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias); nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit *subjekti i rivlerësimit konsiderohet me mangësi, kur ka treguar cilësi të papranueshme në punë* – konstaton se:

Për mangësitë e evidentuara në dosjen gjyqësore që i korrespondon vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti me nr. ***, datë 28.3.2022, të referuara sa më sipër, trupit gjykues, duke marrë në konsideratë se gjatë vlerësimit të aftësive etiko-profesionale ndaj subjektit të rivlerësimit:

- nuk i rezultuan elemente që ta identifikonin me të meta apo probleme në gjykimin e rasteve të tjera individuale, të tilla si mosrespektim i afateve ligjore, referenca të gabuara ligjore, dosje të paplota, sipas ligjit nr. 76/2016;
- nuk i rezultuan të dhëna apo gjetje negative nga regjistri i ankesave dhe procedimeve disiplinore;
- nuk i rezultuan të dhëna negative lidhur me trajtimin e çështjeve, sipas neneve 75 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016;
- nuk i rezultoi një numër i konsiderueshëm denoncimesh;
- nuk u identifikuan problematika që mund të cenonin figurën e saj,

arsyeton se mangësitë e evidentuara në dosjen gjyqësore që i korrespondon vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti me nr. ***, date 28.3.2022, nuk janë të mjaftueshme për t'i çmuar ato si sjellje e përgjithshme dhe e vazhdueshme e saj, si dhe nuk janë të mjaftueshme për ta identifikuar si një magjistrat, e cila ka një mënyrë/praktikë pune të papajtueshme me pozicionin e saj.

Sa më sipër, trupi gjykues çmon se mangësitë e konstatuara në këtë çështje janë të tilla që mund të përbëjnë shkaqe për procedim disiplinor, sipas dispozitave të ligjit nr. 96/2016, që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në përfundim, për kriterin e vlerësimit etiko - profesional, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59, pika 1, germa “c”, e ligjit nr. 84/2016.

Sa i përket dosjes gjyqësore që i korrespondon vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti me nr. ***, datë 28.3.2022, bazuar në nenin 40, pika 1, germa “c”, nenin 59, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe në ligjin nr. 96/2016, çmon ta transferojë këtë çështje pranë organit kompetent për inspektim për shkelje disiplinore.

Vlerësimi tërësor i çështjes

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej saj, çmon se:

- Lidhur me kriterin e pasurisë, duke analizuar konstatimet e mësipërme, çmon se ato nuk janë të tilla që të çojnë në lindjen e dyshimeve për të ardhura të paligjshme, deklarime të rreme apo fshehje të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, vlera e pamjaftueshmërisë financiare, e shpërndarë në dy vite, në raport me provat indirekte të depozituara për të ardhurat para martese, masës dhe impaktit të tyre në gjendjen financiare të subjektit dhe procesit në tërësi, çmohet nga trupi gjykues si rrethanë e pamjaftueshme për cenimin e kriterit të pasurisë.
- Lidhur me kriterin e figurës, trupit gjykues nuk i rezultuan elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës apo elemente të tjera që mund të cenojnë figurën e subjektit.
- Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko - profesional, duke marrë parasysh qëllimin e vlerësimit të aftësive profesionale, siç parashikohet nga Kushtetuta, trupi gjykues vlerëson se mangësitë e konstatuara vetëm në një rast për subjektin e rivlerësimit nuk janë të mjaftueshme për të arritur në vlerësimin e saj “me mangësi” ose si “e papërshtatshme”. Sa më sipër, në konkluzionin përfundimtar, trupi gjykues nuk mund të arrijë në një vlerësim tjetër për subjektin e rivlerësimit, përveçse “ e aftë”.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, çmon se subjekti i rivlerësimit plotëson kushtet sipas nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke arritur: nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe të nenit 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Vjola Canaj, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë.
2. Transferimin e dosjes gjyqësore që i korrespondon vendimit gjyqësor të dhënë nga subjekti me nr. 129, datë 28.3.2022, pranë organit kompetent për inspektim të shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.
3. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
4. Ndaj këtij vendimi, me përjashtim të pikës 2, mund të kryhet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
5. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 23.11.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Pamela QIRKO
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka